Daut Dauti

SYRI I KEQ

Editor
Azam Dauti

Recensent
Halil Zendeli

Daut Dauti

SYRI I KEQ

Shkupi
Shkup, 2O17

PARATHËNIE

Në këtë përmbledhje, të katërtën nga opusi poetik, ndjej të nevojshme të jap disa sqarime të cilat jepen rrallë nga autorët. Kjo përmbledhje poetike vjen pas disa veprave të tjera në prozë dhe publicistikë, për t'iu bashkangjitur tri veprave poetike që lajtmotiv kishin ëndrrën("Ëndërr e përdalë", "Shartimi i ëndrrës" dhe "A vdes ëndrra?"). I kthehem vallë dashurisë së parë, poezisë? Nuk do të kisha thënë, sepse poezinë asnjëherë nuk e kam braktisur që t'i kthehem, po vetëm se "ka pushuar" përkohësisht përderisa janë botuar veprat tjera. Megjithatë, ka një specifikë në këtë përmbledhje, është një bashkëdyzim i poezive të viteve të fundit dhe poezive të rinisë djaloshare. Nuk është kjo një përpjekje për të bërë bashkim të panatyrshëm midis poezive që kanë lindur së voni, dhe atyre të dikurshme, por një larje borxhi ndaj asaj krijimtarie të cilën në kohën kur i kam botuar veprat e para poetike, i kisha lënë anësh, që t'u kthehem sërish në një kohë më të mirë, e jo se i kam lënë si "të dorës së dytë". Unë këtë vlerësim e them me një rezervë relativizuese, edhe pse kthimi te to më duket si një ngjallje e "ndjenjës prindore" ndaj "fëmijëve" të vet "të harruar". Duke shfletuar shënimet e moshës më të re, sikur ndjeva që vërtetë t'i kisha lënë pasdore, sikur të ishin "fëmijë jashtë kurore" e me këtë dhe "të padenjë" për t'i treguar para botës, sikur të ishin "të lindur" nga një mëkat.

Jashtë këtyre vrojtimeve zgjohet dashuria ndaj çdo "lindjeje" qoftë edhe "të padenjë". Kështu duken

shumica e këtyre poezive. Të bukura ose më pak mbresëlënëse, të filozofisë së jetës, ose të motivuara nga ndjenjat e forta të afshit rinor ndaj muzës poetike, me gjithçka që ngjyros atë moshë, me shumë ndjenja të forta, magjepsje, me shumë dashuri ku poeti dhe muza assesi të gjenden, me shumë ndarje në moshë të re, shumë shqetësime të një djaloshi që për një kohë të shkurtër nga një gjimnazist bëhet ushtar, një moshë ku gërshetohen realiteti dhe ëndrrat..., janë motive që më duket se meritojnë për t'iu kthyer si autor, për të korrigjuar një gabim që i kam lënë anësh me vite, duke pritur një moment si ky për t'i nxjerrë në libër. Në këtë rast do të shtoja se kur i mora përsëri nëpër duar, vendosa që në maksimum të ruaj kontekstin kohor dhe moshor të tyre, jo për të arsyetuar a priori shtalbësinë e tyre, por ngase më duket se ngjyrimi kohor dhe emocional në këtë rast shkojnë si një gjë e pa ndarë, diç që ia përngjan perin gëzofit.

Unë si autor, përkundër padrejtësisë që ua kam bërë këtyre poezive duke i lënë t'i mbulojë pluhuri i kohës, asnjëherë nuk kam pushuar së dashuruari ato, pavarësisht nga vlerësimi subjektiv dikur për to se nuk janë plotësisht "të pjekura" për të dale para lexuesit. Jo, ky nuk duhet të jetë pretekst para kritikës letrare, porse vetëm sqarim i qëndrimit të autorit ndaj një pjese të krijimtarisë së vet në një kohë dhe moshë më të hershme.

Cikli:

KUR FATI S'I DO HERONJTË

HERONJTË E KËNGËS

(Sipas motiveve të këngës popullore "Çou, Rexho...")[1]

[1] Jam rrëqethur, si gjithkush tjetër, saherë që do ta kem dëgjuar në fëmijëri dhe rini këngën "Çou Rexho...", sepse e kam përjetuar atë tragjedi si një film ku heroi vdes nga një situatë banale në ditën më të lumtur të tij, duke pritur nusen në dasmën e tij. Kushdo që ta ketë dëgjuar këngën, ka shpresuar që ngjarja për të cilën flet ajo, të jetë vetëm një rrëfim artistik, si shumë këngë të tjera, prapa së cilave vetëm mund të supozojmë nëse ka diç të vërtetë ose jo. Edhe për këngën kushtuar djaloshit fatkeq me emrin Rexhë, kam shpresuar të jetë pjellë e imagjinatës krijuese të këngëtarit popullor, por për fat të keq, më vonë kam lexuar se kënga ka lindur nga një ngjarje e vërtetë. I frymëzuar nga kënga, në librin tim të parë shkrova dy poezi, një për vetë heroin e këngës, Rexhën dhe tjetrën për Nusen e paemër të Rexhës, dy personazhe fatkeqe të këngës, duke dashur të krijoj një realitet të ri artistik, një lexim të lirë të ngjarjes tragjike, një përpjekje letrare që pas kësaj vdekjeje absurde të gjej ndonjë shtresë tjetër kuptimore, një motiv tjetër, e jo vdekje banale nga shkelmat e kalit Allxho. Ndërkohë, disa gjëra dolën në shesh rreth vërtetësisë së këngës me elemente krejtësisht të reja, që vrasjes banale të dhëndërit në ditën e dasmës së tij, i jep një dimension tjetër, një motivacion artistik çfarë shpesh është trajtuar në letërsi ose film...Kështu, këngëtari Demir Krasniqi (http://lajmi.net/kush-e-vrau-rexhen-ne-grazhdin-e-kalit/), ka shkruar se këngëtari i mirënjohur Qamili i Vogël (Qamil Muhaxheri) e paska hulumtuar rastin dhe ka zbuluar se Rexhën nuk e ka mbytur kali Allxho, por xhaxhai i tij. Në të vërtetë, xhaxhai i tij e ka marrë nënën e Rexhës për grua që mbetet e ve pas vdekjes së burrit.

Axha, i cili ka qenë njerku, e ka rritur Rexhën, por nga motive të ulëta, e ka vrarë mu në ditën e dasmës që të mos bëhet trashëgimtar i hises së pronës që ia ka lënë i jati, por e gjitha t'i mbetet xhaxhait. Këtë të vërtetë këngëtarit Qamili i Vogël ia paska treguar vetë nëna e Rexhës…(Ngjarja ka ndodhur në fshatin Stubëll, në jug të Serbisë së sotme, diku kah fundi i shekullit XIX). Elementet e reja të kësaj tragjedie edhe një here më frymëzuan për një qasje më të plotë, për një refleksion të ri artistik…Në këtë dramë njerëzore ka diçka universal dhe motiv artistik që është trajtuar në gjithë letërsinë e përbotshme: krimi për të arrirë ndonjë cak, ndonjëherë i ulët(për pëfitim pasurie) e ndonjëherë i lartë(për përfitim kurore a pushteti, për fame të pamerituar...). Në ngjarjen e kësaj kënge, është gërshetuar një dramë njerëzore që ka një thurje dramatike që i përmban këto motive universale …

1. (Heroi i pavdekshëm i Këngës)

Krushqit e Këngës
ta sollën Nusen e Re
Me jehonën e Kujtimit
të përtejkohshëm
"Çou Rexho…"
Ishe a s'ishe ti Bandilli
Që grindte zanat e malit

Buzë shtalb
Do të puthje natën e parë
Por të qe ndarë roli nga fati
Se s'mund të zgjidhje vetë
Për të qenë i lumtur
Dhe Hero Anonim
Apo i pa fat e i Pavdekshëm

Hamletët e tragjedive
Gjithnjë luajnë me vdekjen
Duke ecur litarit mbi humnerë
Deri në frymë të fundit
Kishe luajtur shumë herë edhe ti
Në Logun e Burrave
Kur të binte kapuçi
Ti sërish në kokë e veje
Ishte lojë e loja përsëri
Mund të vazhdonte pa fund

Dasmë e madhe, po,
Por si të ishte ndodhi e huajtur
Malësia s'qe Trojë
Nusja s'quhej Helenë
S'kish kush me kë të dalë në Log të Burrave
Për një dashuri të përbotshme,
Por si në skenë teatri absurd
Ti duhej të vdisje për kot?!
Një kalë që s'ish personazh dasme
as i drunjtë si në Trojë
që prish jazinë e "perëndive"
Por Allxhoja hyri në këngë
Që ta përjetësojë vdekjen
si ta kishin futur fallxhorët sykëqinj
një pështjellim tinëzar fati
Një kurdisje
Ku Hamletit futen në rrugë qorre

Shumë pikëpyetje përtej dhembjes,
Si ndërroi Allxhoja karakterin
për ta kënduar si hamshor?
Kush të çoi në ahur ditën e dasmës
T'i jepje tagjinë e fundit
Dhe të puthje pavdekësinë?
A mund të shkelmonte vërtet
Të zo'në e vet ati q'e kisha shaluar saherë?
A ngriti kush dolli
Pasi të ra plisi
Në "*grazhd të kalit*"?

Hamleti do ta kishte zili
Se s'të lanë të përpëlitesh vetë me hamendësime
Të jetosh ose jo
Po ta kishin kurdisur
një shkelm hamshori në varg kënde
një ditë e gëzuar tragjedi të përfundonte

Mbetën Krushqit e Këngës
Të rrëshqasin si nëpër furtunë
me jehonën e dhembjes
Nga kohë e zverdhur e përtej harrimit
"Çou Rexho...
Më i miri i nënës o..."
Të të kujtojmë hero pa heroizëm
që dhe dasmave frikën t'ua kemi

2.(Heroina tragjike e paemër)

Heroinë tragjedie dhe e paemër
Një fat me hile
Që s'u përmende
As si "Nusja e Rexhës"?

Ndonëse për ty u bë dasmë e madhe
Krushqit e Këngës
Të përcollën në fatin tënd
Nëpër shi e lot
Por ai që të la të ve
U bë i pavdekshëm
Ti je jetën mbete e harruar

Një shi i përvajshëm dhe i përmallshëm
Do t'i shkonte natës së parë të nusërisë
Pa përqafim dhëndëri

Pikat e ftohta
Trokisnin në zemrën e shtangur
Sikur të dije ç'gjëmë të pret

Shirat e motmotit
Shpërlajnë pluhurin e harresës
Kohë e zverdhur në mjegull
Sot e atë ditë kur të priste dhëndëri
Hamleti-dhëndër,
Ah, *"Rexha i Nënës*
Në grazhd të kalit"
Pa plis në kokë

Ç'mendime të liga të silleshin në kokë
Gjersa koçia e nuses çante rrugën e përbaltur?
Kujtimet e mallëngjyera të moshës vërshonin
S'mund të kthehesha më në fëmijërinë e sapo lënë
Por dhe nusërimi yt pa dhëndër
Ishte një fund rruge pa kuptim

Dhëndrin s'e kishe njohur
Se të martuan me zakone malesh
Por i madh qe pikëllimi
Se s'do të jetoje ëndrrën
Që kujtoje se të qe shkruar

E padrejtë dhe kënga
As një varg për dhembjen tënde
As klithmë, as vaj, as lot,
asnjë keqardhje
Ndonëse gjithë ata krushq
Për ty kaptuan maleve

Por prapë një ngushëllim
më shumë fat do të kishe ti
S'hyre në këngë që të vdisje
Mbete e paemër të jetosh jetën
Kushedi ku
kushedi sa e lumtur

Një vejane e re dhe e bukur
Një nuse jo tipike
Me ëndërr të sëmbuar

3.(Allxhoja i pafajshëm)

(Kalit që e akuzuan për vrasjen
që e kishte kryer dorë njeriu…)

O mor' Allxho t'u k'putt' jela,
Si ma mbyte Rexhën n'shkelma..."

Të bënë të përmendesh
si rrallë kuaj të historisë
por famën do ta kishe dhuruar
për këmbim pafajësie
si ditën kur askush s'e deshifronte onomatopenë
Kur n'hingëllimë qaje dhe ti
Për t'zonë e hedhur
Te thundrat me patkua

Hingëlloje për t'u shfajësuar,
Se Dora e Mësheftë
Nga ti drejtoi gishtin
Për të fshehur gjurmët e veta
Ishe personazh i duhur për t'u nxirë
Dhe për këngë
memeci nuk mund të lajë veten

Të ndanë ty rolin
E heroit të urryer
Të futën në këngë
prishës lumturie
Që të të urrejë kush të dëgjojë këngën

Një vrasës pa motiv
Në një çast tërbimi

Do të dukej bindës
Për vdekje absurdi

Vaji i nënës zemërplasur ta vulosi fatin
Vrasës bukëshkalë në sytë e botës

Do të kishe hingëlluar gjer në qiell
Kur ta dëgjoje emrin tënd në këngë
dhe mallkimin e nënës
por askush s'do të kuptonte
që ti kërkoje pafajësinë
dhe kënga të hodhi në kujtesë
dhe dorëziu jetoi i lirë
me ndërgjegje të fjetur

4.(Nëna e pikëlluar)

Lotët rrëke ndotën këngën
që duhej t'ishte e gëzuar
kuja jote dhe vaji i motrave
"...Çou Rexho, çou djalo
...Sot ma i mirë po m'dukesh, o!"
dhe krushqit që bënë kortezh mortje
i dhanë krah dhembjes përmotë

Një ditë e lumtur duhej të ishte dasma
Por ty të çahej zemra më dysh
Një gjergjef bosh,
i pa arritur mbet

I besove anatemës për të pafajshmin
Allxhoja i shkretë sy kish' e gojë memec
As të këndonte as të qante

S'kishe pse të shpifësh ti,
dhembja t'kish errësuar mendjen
sa të mos dyshoje që s'ish Allxhoja
ai q'e mbyti *"...Rexhën n'shkelma"*

Një jetë zezonë pas dasmës
Urrejte dasmat ngado që bëheshin
Çdo daulle furtunë shpirti të sillte
Urrejte dhe kuajt ngado që kalëronin
por s't'u nda as dyshimi
që t'u bë hije mali

Ti s’dije a s’deshe të ndalësh këngën
Që nga shpifja mori dhenë
Ose nuk dije a vonë kuptove
Që me vrasësin ndaje shtratin

Dy ferre jete dhe vite shterpe
Dhembje për djalin
Neveri për jetën me vrasës
Me jehonën e përtejkohshme të dhembjes
Kur ishte vonë ta ktheje këngën
Pos mllefin në vete ta bluaje
Zemërimin me burr’n dhe at’n e fëmijëve tu
Në vete ta ruaje

5.(Krushqit që u bënë varrtarë)

"...Ooo, more krushq, ju hani e pini
Nesër Rexhën n'dhe t'ma shtini..."

Sa ishit, dhjetëra, qindra?
Sa mund të ketë krushq në një dasmë?
lumturia që sjellin s'matet me numra

Por për një dasmë që zhbën harrimin
Doemos ndonjë emër të mbetej në kujtesë
Si quhej kryedasmori,
Kush qe bajraktar,
E cili usta i mëshonte daulles?
E kush i printe valles...?
Asnjë shkresë në arkiva kohe
As një emër në këngë
Si ushtarë të paemër
Që luftuan përkrah një heroi
Zulmëmadh

Por "Udha vade s'ka"[2]
Ju çuan në rrugë për Nusen e Re
U kthyet me vaj në oxhak
Klithma e nënës ju mbajti gjallë
"o ju krushq hani e pini
Nesër Rexhën n'dhe t'ma shtini"
Se të rrallë janë krushqit
Që sjellin nusen e dhëndrin çojnë në varr

[2] Shprehje popullore shqiptare nga treva e Dërvenit të Shkupit

6.(Heroi i padukshëm: Vrasësi[3])

(Poezi pa emocione dhe bukuri)

Një akt makabër
përgjaku gjakun e oxhakut

Një dorë gjakftohtë
një terr shpirti
sy grykës

As dhimbje për t'afërm
As frikë ligji a Zoti
vetëm sy të errësuar lakmitarë
përtej dhembjes e frikës

kur iu fik drita e syve nipit
ty t'u hapën arat e gjelbëruara
sikur do të trashëgoje mbretëri
ku do të sundoje me syrin e uritur.

[3] Sipas pohimeve të këngëtarit Demir Krasniqi(http://lajmi.net/kush-e-vrau-rexhen-ne-grazhdin-e-kalit/), duke u bazuar në rrëfimin e këngëtarit Qamili i Vogël(Qamil Muhaxheri), nëna e Rexhës ka zbuluar se vrasësi është axha i tij, por nuk ka detaje se kur e ka zbuluar këtë fakt, a e ka ditur ajo nga dita e parë ose vetë vrasësi, me të cilin e kanë martuar pas vdekjes së burrit (I cili ka qenë vëllai i tij) , do të jetë rrëfyer më vonë. Ka gjasë që ky zbulim të jetë bërë më vonë, sepse jeta e këngës tregon se është besuar që vrasësi i Rexhës është kali Allxho.

Por kur ti mbyllje sytë në gjumë
Ndërgjegja me zërin tënd fliste jerm
"të vrava s'të vrava, të vrava s'të vrava"

Duhet të ishin gjakftohta këto vargje
si dheu i ftohtë
që mbuloi një rob të pafajshëm të perëndisë

KTHIMI I DORUNTINËS
(Tekst kënge)

Zogjtë e malit ç'po cicërojnë.
"I gjallë e vdekur po kalërojnë"
Zogjtë në terr ç'po pështpëritin:
"Gjallë e vdekur, ç'po degdisin!"

(Doruntina):
Dëgjo terrin vëlla i dashur,
Që kur zogjtë dinë të flasin!
Mos fshih f'tyrën, zemërplasur,
Më shiko me sy, ta shuaj mallin.

(Kostadini):
Koha s'pret, o motra ime,
Kujto fjalën që ta dhashë dikur
Ka kohë për çmallje, kujtime
E pafund nata e varrit nën gurë

(Të dy):
Vëlla e motër në kalërim
Një shtegtim nëpër amshim
S'i bën vdekja ballë tundimit
Vëlla e motër përtej harrimit

(Konstadini):
S'gjeta prehje n'vetminë e varrit
Shalova besën mbi shalë të kalit
Vrava kohën, vrava mërzinë
Eca fushë e male, për ty, Doruntinë

(Doruntina):
E rëndë është tepër, pesha e premtimit
Përtej vdekjes, përtej harrimit
Nuk kam lot n'të huaj dhe
Dhe venitem për ty aty ku m'le

(Të dy):
Vëlla e motër në kalërim
Një shtegtim nëpër amshim
S'i bën vdekja ballë tundimit
Vëlla e motër përtej harrimit

FARË DJALLI

(Poezi për poezinë e humbur kushtuar
femrave të dhunuara në luftërat e fundshekullit në Ballkan)

Rrallë qëndis strofa me rimë
Po dora vetë u iku vargjeve t'lira
dhembja meriton më shumë sqimë
jo veç vargje shkruar nga mëshira

Një nënë e re shtrirë n'psikiatri
Me fëmijë në bark, në fund shtatzënie
ta lindë a ta vrasë me gjakftohtësi
dilemë hamletiane të një lehonie

E sfilitur, e dërmuar, shpirtçalë
Pezm e vrerë, jetë n'pendesë përmot
Në pleh ta hedhë, a ta lë të gjallë,
Një luftë epike, aman, ndih' o Zot,

Gjysmë kopil, gjysmë farë e saj
Gjysmë engjëll, gjysmë lanet
Shtysë për t'vra' djallin, pa kurajë
Bashkë me gjysmëfrytin e vet

"Trofe" lufte, plaçkë, e çnderuar
kauzëmbrapshtit s'lanë gjë pa nxi'
dhe një fëmijë pa faj, pa të kaluar,
nga urrejtja e kujtimi të bëhet fli

T'i japë shans një jete të re
apo fund zezonës, me litar a drapër
Të marrësh jetë, s'lë asnjë fe
Po jeta më të, sikur n'gji të mbash gjarpër

T'jetosh me ferrin, është si një plojë
Kujtime që s'shlyhen, kush s'u bën ballë,
Një fëmijë i pafaj, në paqe të rrojë
Që s'do t'dinte që i et qe një djall'

Sikur harresa gjithçka të mbulojë,
Të kalonte jetën, pa të kaluar
Prapë përpara ai fëmijë do t'ia kujtojë
fytyrën e djallit, të reinkarnuar

E lënë me "shenjë", në shpirt vragë
fytyra të shprishura, ankth i vazhduar
Çfarë prehje n'rrënoja e flakë
Engjëll e djall, betejë e papërfunduar

E humba poezinë e mbarsur mëni
S'di të them si përfundoi ky rrëfim,
Ç'ndodhi me atë grua, me atë fëmi'
Një epilog i pritur, akt n'dëshp'rim?

VETMASHTRIM

E,
Po të
Ndodhte
Një mrekulli
Njëherë në jetë
N'Vit të Ri
me të vërtetë t'na sjellë sihariqet
Ëndrrat t'na bëhen zhgjëndërr
Zari
Të na bjerë për atë fat që na
mungon si një premi e beftë lotarie që i bie
të pastrehit
si shkëndi' drite pas një nate të pafund kur
e kërkojmë vetveten, kur e kërkojmë katrorin
e humbur
të mozaikut të lumturisë së idealizuar që i rendim pas
caqesh të amshuara që s'i dallojmë
se te gjërat e vogla fshihet lumturia
kur sytë e përpijnë vesën e mëngjesit a dritën që s'është
vetëm diell
në zemrat e mërdhira nga rrugë e gjatë, por dhe bukuri
e dashuri të amshuara
por dhe fshehtësitë
për të cilat do të ishim të pikëlluar nëse një ditë nuk na i
servir
në sofër një Vit i Ri
si frute më të ëmbla të gjitha dëshirat tona
si një mikpritës bujar

i cili me zemrën fisnike do të na thotë: Urdhëroni,
shijoni frytet e lumturisë,
çkado që deshët e keni në sofër, çka do të bëni vitin
tjetër?
Fat ose jo, përherë na mbeten edhe për vitin tjetër, caqe
të paarrira që të kemi përse
Ta presim lajthitjen e ndërrimit të moteve
Gëzuar për mashtrimin e shpifur!

BOSHËSI

Për kë ta ndërtonte shtëpinë,
Shtëpinë gjashtëdhomëshe
Për tri gojë?
Apo për një grusht eshtrash
Të nënës plakë?

Tri gojë,
Një bashkëshortësi
Dy kate Kullë Iluzioni
me djep që qan i zbrazët
për vaj fëmije në oxhak

Për kë ndërtoi gjithë këtë shtëpi?
Kush do t'ia zbukuronte pasvdekjen?

N shtëpinë e vjetër do të kthehej
E nxirë me tym oxhaku,
Vetëm vaj fëmije të dëgjojë

VRASËS SHPIRTI

Hije njeriu në terr!
Një ofkëllimë çmendurake.
Hija vështroi diku lart, lart
Në një pikë që veç ajo mund ta shihte,
Bërtiti me sa zë kish:
"Bëra një krim!"

O njerëz me shpirt të fjetur
Vallë e dini që u bëra vrasës,
Se nga zemra ime nxora mllefin,
Që si re ngrihet padukshëm,
Që më çan planc e zorrë,
Për të vetmen gjë:
Të vras njeri!

Ja, askush nuk mund t'më zbulojë,
As CIA, as UDB-a, as Sigurimi
As qentë më të aftë të hetuesisë,
Nëse vetë nuk zbulohem

Unë vrava,
Por ju s’patë gjë
Kur lëshoi teposhtë kokën
Dhe u plandos
në gjurmët e natës
Njeriu që vrava: UNË
kjo që shihni, s’është tjetër
pos hijes sime të çalë

E kam mashtruar drejtësinë
S’dinë si t’më padisin
se s'ka ligj për njerëzit
që vrasin shpirtin e tyre!

TAKIMI ME FATIN

E takova fatin
diku në periferi të qytetit,
Unë isha në trans
E ai më dukej se çalonte

Dritat e neonit na bënin dritë,
Si reflektorët në skenë drame,
Dhe ky takim imi me fatin
Ngjau si dyluftim heronjsh kryeneçë

Ia shkela syrin t'më lëshonte
Kësaj here s'qesh gati të sulem,
Më le të kaloj, gjë s'kërkoj gjë, i thashë
Se kur kërkoj, ti çartesh

Vërtetë isha në trans,
Kur takova fatin
në një rrugicë diku në periferi,
Si dy shokë të mirë u ndamë pa kacafytje
Dhe të dytë nxituam hapin në errësirë
Drejt caqeve të asaj nate

(Shtator, 1981)

FATI S'I DO HERONJTË E VET

E çojmë jetën me fatin në gojë
E kemi cak për ta arritur
E kemi rrugë për të ecur

Jemi fatlumë a fatprerë
Kërkojmë gjithnjë më shumë
Për lumturi përherë në inerci
fatin në ndihmë e thërrasim
ose fajtor e shpallim
për jetën shkuar kot

Dhe vazhdojnë gjakimin
pallate ëndrrash të ngrejmë
me forcën e mendjes ujin ta çojmë përpjetë
mundemi, mundemi kur ia mësyjmë cakut
po dhe pak fat të kemi,
fati në anën tonë të jetë

Po pse njerëzve iu duket se shumë hile bën fati
Dikujt i jep me grusht, e dikujt me tërplotë
Shëndet, karrierë, harmoni shpirtërore,
Dikë e gremis teposhtë,
Poshtë e më poshtë

Të gjatë janë penjtë e fatit
Në shkretirë ose xhungël
Në fushëbeteja a në paqe
Ua ndan rolet njerëzve të përpëliten

Si në shfaqje farse ose absurdi
Dikush të pret Godonë përjetë
Dikë e lë nyjet gordiane
t'i zgjidhë vetë me litarin në fyt

Dikur, sot ose kurdoqoftë
Një lojë e pafund e çdo frymori
Lojë peshqësh të mëdhenj e të vegjël
Për kë të ketë mëshirë fati më shumë

Kë do më shumë e kë më pak
Nga heronjtë e vet në log
I do apo s'i do fati
Apo heronjtë penjtë vetë i këpusin
S'duan t'i udhëheqë fati...

Cikli:

STINA SHTALB E VARGUT

SI TË HESHTË KËNGA

Mos hesht, ti këngë,
Mos të të p'shtillen notat
Tingëllo fuqishëm
mbi timpanin e ndjeshëm
të veshit shurdh,
thuri vargjet në ritmin e atomit
për kaptinë të re
në legjendën e qytetit gri

Çap pas çapi, këngë,
Mund t'ia marrësh ciu-ciu-n zogut
E kaltërinë e fluturimit
t'ia shkrish në notat tua
Të marrë ngjyrën dhe pastërtinë
E një pikë vese
Për një varg të djersirë

(Shkup, 1978)

GJAKIM NË QYTETIN GRI

E ndal shikimin
Te Kulla e Sahatit
Një kohë të ikur kot
Tregon ora
Kohë kataklizmi shpirtëror
Të vdekjes së plogësht
Dhe të ngjalljes së përjetshme

Çohem mëngjeseve
I rilindur me çdo ditë të re
Një varg poezie
më bën të fortë
Gjakim jete në qytetin gri
Me këngën që refuzon të heshtet

Dhe ti o lum që kalon përtej kohës
Turbulloi me valët tua këto vargje
Nga kjo kronikë jete monotone
Bëje një dramë heronjsh të sfilitur
Duke luajtur mbi asfaltin gri

E ti o njeri i shfytyryar
që sillesh vërdallë
me vallen e jetës a vdekjes
sikur gjakftohtë mbi teh të shpatës
vraje bezdinë
e ke lirinë që të bredhësh botës

(Shkup, 1979)

POEMTH PËR TY

Sonte si çdo mbrëmje tjetër
Me laps në dorë mëtoj të shkarravis
Ca fjalë me shumë bukuri
Për t'i qëndisur vargjet
Që i shkojnë një dashurie

Është si çdo dashuri kjo e jona?
Atëherë përse duket më e veçantë,
E dalluar si asnjë tjetër
E përjetuar duket si një ankth pa fund?
Përse ka më shumë se çdo tjetër dashuri
afsh, vuajte të pashpjegueshme,
dhe shumë pse-je pa përgjigje?

Gjurmët e lapsit lënë në fletë
Kujtimin për ecjen e fundit
Brigjeve të heshtura të lumit
Natën kur rrjedha e tij
U ngjasonte hapave të plogësht
Në terrin e pafund

Lapsi shkarravit
Duke u tretur
në shikimin e përhumbur
sytë të thellë ngjyer me dritën
që s'shkëlqen natën e përsiatjeve
por vetëm një përpëlitje në terr
në dritën e zbehtë të neonit
mjegullon parafytyrimin

Më buzëqesh hëna
Përmes dritares së hapur
Dhoma kundërmon nga djersa
Është vonë edhe për përsiatje
Ora e murit tregon dy pas mesnate
Edhe një natë e kotë në vargje?

Tinguj me zë të mekur
Shpojnë terrin përvajshëm
Më bëjnë veshët
a parafytyroj violinën në mur?
Si një pamje surrealiste
lidhet me ndjenjat e trazuara,
Tinguj vargjesh dhe pëshpërima bashkë

Në qelqin e dritares
Më shfaqet një hije
Një kokë femre të përdalë
që më buzëqesh me cinizëm,
dhe m'shikon me sytë e këqinj
tallet me përsiatjet e mia
për dashurinë e idealizuar,
"ja, kjo është jeta!
Lëri vargjet e tua!"

"Shporru që këtej!"
I them hijes,
"Më lë të ëndërroj,
Ëndrra ime s'ka çmim,
edhe sikur të jetë e pa arrirë!"

Dalldisja pas vargjeve
mund të jetë e kotë
Forca e ndjenjave i shkapërderdh
Një rrëmujë ku s'dihet pesha e fjalës
Sikur gjethet
që i trazon veriu tinëzak

Një thurje e shthurje dramatike
e pazakontë
dashuria vdes pa lindur

(Shkup, 1979)

TUFË SEKRETE VARGJESH
(Lules së fëmijërisë)

Ç'të bëj tash me këtë grusht vargjesh
t'i fshehë thellë në zemër
dhe t'i ruaj me zili
t'mos i ndaj me askënd
T'bëhem më shumë egoist seç jam
Apo t'i dhuroj ty
që herë pas here
t'i shpalosh si xhevahirët nën gurë
t'u hedhësh nga një sy gjakftohtë
Që të mos lëndohesh
Janë shkruar për ty
ndonëse s't'i dhashë në moshën e çiltër

Mund ta marrësh
këtë gërshet vargjesh
ta ruash si një fshehtësi
që s'i matet dot vlera
mund të më kujtosh
si një bandill të fshehtë
Të përrallës që s'pati fund,
Kur t'i magjepsësh plakat e katundit
me bukurinë tënde nusërore
e të të gufojë gjoksi në pritje të dhëndrit
hesht përjetë për vargjet e çiltra
se kushmosi të deshi
e ti vetëm një do zgjidhje

Dikur ato vargje dirgjeshin për ty
Tek rriteshe dhe bëheshe më e bukura
Lule e rinisë
Sot të përcjellin në "udhë të mbarë"
Në jetën tënde si grua e re
me një bandill tjetër,
larg syve larg zemrës
të vetmet gjëra me vlerë që mund të dhuroja
ishin këto vargje të fshehta
nga shikimet e përflakura kur mbushje ujë
Te çezma e katundit ku s'do jesh më.

(Viteve 80-të të shekullit të kaluar)

HIJET

Kërkoj e s'i gjej shtigjet
Andej nga hodhe hapat
e pavullnetshëm
Gjithçka është mbyllur
Pas teje Hijëdrita
S'mbeti gjurmë
Veç kujtimit të amshuar

Kërkoj gjurmët që le pas
Të gjej kuptimin e hapave
që të largonin
E që s'gjej gjë veç ikjes sate

Pa arsye bëhem nevrik
dhe kthehem te filli i lëmsheve
me enigmën për etjen
etjen që s'ma shuan asnjë ujë

I dhe kurajë dashurisë,
Ishte një besim qorr
nuk besoja se një heroinë si ti
mund të gjunjëzohet
duke flijuar ndjenjat për një frikë
që s'e zbulove kurrë

Më dhemb fundi Hijedrita
ike me shpirtin çalë
Si një varkë e përmbysur
tretur në rrjedhë të çartur

(Shkup, 1979)

SI MË NEVRIKOS

Më nevrikos shumë,
Kur të shoh të buzëqeshësh me tjetër.
Egoist jam dhe s'më bëhet qejfi
Kur qesh me shakatë e pakripa
Të atyre që duan të të pushtojnë,
Përskaj një bandilli të fshehtë,
Që çdo fjalë e matë
Për të të magjepsur.

S'të bën përshtypje shikimi i fshehur
Se ti me ëndje dëgjon çmos,
Të joshin fjalët e bukura bosh,
Që s'i kupton urtësitë e kufizuara
Jeta s'është veç urtësi.
Zhytesh në pellgun e epshit,
Duke kundërmuar djersë
e erë deodorantësh,
Lakuriq e fytyrë skuqur
Pas perdeve të dritareve të avullta.
Se dashnori yt s'të tregon më barcoleta,
Vetëm ndez cigare dhe as të shikon me sy,
Ti për të ishte vetëm një leckë.

Tash më dashnori yt i fshehtë
ka humbur dëshirën
Të të impresionojë me 'foret' intelektuale.
Për kë?

E kënaqur mbetesh,
Një mbrëmje të bukur mund të shënosh
në ditarin
E bredhjeve tua.

Një shfryrje e përligjshme,
Ta kënda të shëtisësh në vetura luksoze
E të mbështillesh me çarçafë mëndafshi
Dhe si për inat kur zbret prej veture
sheh dashnorin tënd të fshehtë
duke qeshur pa zë
Për hallin tënd të zi

E gjora ti!
Vërdallesh në aventurat e natës
Me të panjohurit
që të rrëmbejnë me një gotë te banaku
Që s'kanë ç'të japin tjetër me vlerë
Pos grahmës së vetëkënaqësisë që pushtuan
Edhe një femër mendjelehtë.
Pastaj vjen pendimi
Çka nëse një çast jete
dhe mund të pendohesh
kur të jetë vonë?

(Shkup, 1979)

KUR TË VIJË QERSHORI

Kur qershori të vijë me lajkat e natyrës,
Këpute një lule, merri erë thellë
vallë ka erën e pranverës që iku
apo aromë e saj nuk e ka joshjen
kur në gji kishe plot dashuri!
Shiko qiellin kur të vijë qershori,
Në horizont kur të dalë hëna e zbehtë,
Shiko terrin kur zogjtë bien në gjumë
vallë të kujton pikëllimin e gjetheve
të blirit nën ballkonin tënd
gjer ku të përcolla memec
me frymën e ndryrë

Kur të vijë qershori
e kur të prajnë pastaj shirat
Si atë natë pa shi,
kur mbi qytet bie vapa e verës që vjen,
si një zë i mekur do të të ftojnë kujtimet,
në shpirtin e mundur nga psherëtimat.

Ka mbetur më dashuri
pas një kohe pa ne?
Dhe pak dhimbje
që në gji fsheh.

(Shkup, 1980)

NJË ËNDËRR NË FYT

(Maturantëve të v.shkollor 1979/80
të gjimnazit "Zef Lush Marku"-Shkup)

Atëbotë ua shkrova Poemën
E Ëndrrës së Bukur
Të vetmen që kisha mundur t'ua kushtoj
Kur na lidhte një Udhë që s'dinim ku shpie
Tash e rrëgjova në një vjershë
Se asgjë s'është aq e vogël
Asgjë s'është aq e madhe
Ndjenjat nuk maten me njësi sasie

Se do t'ju fus në Librin e Jetës
kornizë kujtimi
Në Kohën e Zverdhur
Të jetoni gjer në amshim Ëndrrën e Bukur
Fjalën e mbajta

Sot të githë jeni gjetur në rrugë të gjata
T'jetëshkrimit
Ëndrra e Madhe ua lidh e zgjidh
Nyjën e Fatit

Tash bëjnë tjera kohë
As ne s'jemi ç'kemi qenë
Dashuritë e fshehura s'do t'na djegin
E therin njëkohësisht
Me atë çiltëri naive të moshës shtalb

Sepse ndërkohë u mësuam
Me Gënjeshtrën, Mashtrimin
Duke bjerrë kohën e kotësisë
Zbuluam fytyrat me shumë fytyra

Çapkënë dhe bandillë
"të lindur" për vargje
Nga Mësojtorja dolëm në udhët zigzage
Si ekuacion matematikor
me shumë t'panjohura
N' aventurë hazarde të shpirti
Në krahë t' Ëndrrës së Bukur
Përtej kohës së zverdhur

Sa bukur qe të ëndërroje
Pa shije pelini
të jetës së pastajme

(Version i përpunuar i të njëjtës poezi
nga përmbledhja "Ëndërr e përdalë")

KA MUNDUR NDRYSHE

Ah, jetë o jetë që një të kemi
Të kemi një dhe s'ta dimë vlerën,
Kur të vijë dita të të dorëzojmë
Themi si na kaloi, o perëndi,
Ç'është koha në këtë botë,
Gjëja më e vockël
që të mashtron kur matet?

O jetë, o jetë,
e vetmja që na është dhënë,
Një mijë jetë t'i kemi,
njësoj do të kishim jetuar,
Jemi dhënë pa kokë
Pas gjërave që s'kanë vlerë,
Për të zbukuruar jetën

(Sombor, 1981)

DY BOTË

Kristalet e ngrira të akullit në xham
Si membranë drithëruese
dy vazhdat e një jete
dy botë që dergjen

Përtej dritares bardhësia qumështore
Vesh dheun si gëzof i ngrohtë
E ngrica ka ndërprerë lëvizjen e gjallesave
E ai frymor që do të dalë jashtë
Do t'i lë gjurmët e veta
Mbi atë bardhësi virgjër
Gjersa stuhia e re
Të mos sjellë borën e re
Të fshehë shenjat e jetës mbi tokë

Jashtë është nata
Bota ime e parë që dirgjet në erë
Në gjurmët e mbetura të një kohe të ikur
Që rrebeshet ngulitnin kontraste
Si plagë nga thika e ndryshkur
E në mishtë e djegur
erërat ftohin eshtrat
E sot përtej peizazheve
Nën bardhësinë virgjër
Po valëviten ngjarjet e ngrira
Rikthehen dritat, zhvishet jeta ime
Me një jehonë që zhduket

në rrugën e kthimit
Jeta ime rresht
pas kujtimeve

Dy botëra ndeshen
në dy anët e dritares së ngrirë
Dimër i ftohtë po mban jashtë
Valët e erës hanë njëra tjetrën
Dhe grinden.

Përpëlitem dhe unë
Midis ngricës së borës jashtë
Dhe ngricës së shpirtit brenda

(Sombor, 5 shkurt 1981)

SHI BIE

(duke qenë roje në aeroportin ushtarak)

S'ka pak kohë që kam marrë
ndërrimin e rojes
Tani në pistën e betontë
Shikoj si përplasen me nervozizëm
Pikat e shiut
Si kryqëzojnë rrugën mes vete
duke rënë në tokë
Pa kurrfarë rendi e rregulli,
Me zhurmën rrebeshtë

Përreth gjithçka heshtur veç shiut
Dhe kam ngelë unë tani
Që me monotoninë e pikave
Të mat kalimin e kohës shterpë
Që s'po nxiton,
Siç nxiton gjithherë në jetë
Pa vullnetin tonë
fluturimthi në theqafje

Tani po bie shi,
Në vend të borës, shi i mërzitshëm,
Me atë zhurmën e zinxhirëve
Që ngreh skllavi këmbëve
Duke i zvarritur rëndë – rëndë
Në kupolën e mjegullirës n'errësirë
Me kontraste ngjyrëplumbta

Në këtë kohë kur n'qiellin sterrë
s'fluturon asnjë aeroplan,
Pista e aeroportit rri e braktisur
Një shkretësi shpirti me frikën dyftyrëshe
E di se s'ateron asnjë mysafir nga qielli
por syhapur po ruaj në këtë shi
Dhe meditoj për paqen
pranë aeroplanëve luftarakë

Vetëm unë në roje dhe shiu
dimë se ç'është vetmia
dhe bezdia

(Sombor, janar 1981)

BINTE SHI ATËHERË

Në një peizazh të zakontë
shiu i jep imazh një dite pranvere
pikat në vegullimë,
na mbushin frymën freski

Njerëzit gjithnjë i lodh pse-ja:
pse shiu shkon me përmallimin?

Ne atë ditë nuk mund ta zëvendësonim
Vegullinë e ylberit mbi horizont,
në shikimet e etshme për mrekulli
Edhe më shumë përflakej malli
Që afron dy miq që s'janë parë qëkur
Por ty atë ditë të kisha aq pranë,
ndjeja shqetësimin në gjoksin e gufuar
dhe mëkatin që s'ta joshja dot
aromën e trupit

Binte shi atëherë
Pranvera ishte në të ikur
E ti posa futeshe në zemrën time
Se ti ishe pranë
Të dëgjoja tek flisje
Pas gjithë netëve pa gjumë
Duke ëndërruar takimin me ty
dhe kur ndodhi, sikur s'qe fare

Shi binte, një ditë e enjte sekëlldi,
Një ndjenjë e çmendur
na shtynte të ecim ashtu pa fund
Sikur shi kozmik të binte

Dhe s'do të harronim,
Dita jonë e parë bashkë ishte me shi,
Prandaj mua më përngjave në Barbarën
e Preverit
Dhe mallin që shiu ngjall
tek të dashuruarit

Shi binte, një shi i pafajshëm
Që shtonte përmallimin
në shikimet përgjëruese
që rrezatonin dashuri!
E ndaheshin pa zbërthyer
misterin e lamtumirës

(Sombor, pranverë 1981)

KUJTOJ

Kujtoj blirin, hijen e tij mbi ne
Kujtoj hapat tek stacioni i fundit
fytyrën e ngrysur nën bli
Kur pikonte shi,
Kujtoj nyjën që kish lidhë fjalët
Pikëllimin pa lot në sy

I kujtoj hijet tona
Që i gllabëronte terri
sytë bosh plot keqardhje,
Vijat shqetësuese të fytyrës
Në mbresat e një nate
Të vetmes natë
Që kishte heshtjen e stuhishme
Në shtrëngatë

(Sombor, shkurt 1981)

NËN DRITËN E NEONIT

Ecnim pranë-pranë me heshtjet e gjata,
Frymëmarrjet tona dëgjoheshin
më shumë se fjalët
Një kohë shterpë
amulli mendimesh

Veturat kalonin pranë nesh,
trotuari rrëshqiste nën hapa të plogësht
ca fjalë të rralla, të shkapërderdhura
sikur në mortë
kur fjalët humbin kuptimin,

kur erdhëm te bliri i njomë
s'kishte mbetur pikë gjaku në faqe
u shikuam siç shikon i përmbyturi
kah bregu që s'duket

drita e zbehtë neonit na i terronte
edhe më shumë grimasat e fytyrës
dashuria e përflakur fundosej pa shpresë
me fjalët e fundit lamtumirëse
që kurrë s'e zbuluan misterin
e dashnorëve që i ndan dashuria!

(Sombor, mars 1981)

RISHTAZ...

Fajësoj veten
Edhe koha më gjykon
Në procesverbalin e dashurisë,
Dëshmitarët heshtin,
Ne vrapojmë me erërat
e ditët varg e vijë ikin stuhishëm
dita e ndarjes ka mbetur në kalendar,
vallë a mban mend
ç'qe ajo dashuri
që përfundoi si një mister

Megjithatë kur vërshojnë kujtimet
kthehemi te ndarja
duke kërkuar fillin e këputur

(Sombor, mars 1981)

LARG

Do të ketë kaluar mesnata
Gjumi nga qepallat do të ketë ikur
Siç do të kishte ikur dhe durimi i pritjes
Çaste monotonie dhe dremitje bjerrakohe

Do të ketë rënë heshtja mbi sende
Sytë e lodhur kërkojnë prehje,
Në siluetat e territ që lëbyren në pistë
Vargjet e poezisë kërkojnë fjalë, shprehje

Do të ketë ikur mesnata,
por unë rri pa gjumë
E brej veten, humbem në mendime,
frymëzimet qetas si valë lumi
Në gëzhojën e vetmisë mbyllen vargjet

Tani kur këto vargje
Po i thur me përtesë
Tani kur sytë të kërkojnë nëpër hije
Të lodhur nga dita
E djersët e kërkimit damarëve u bien
Shfaqesh siç të doja përjetshëm
Me buzagazin që s'e rezistoja

Lehtësohet barra, gjersa i shkruaj
këto vargje të rrethuara nga terri,
Shpirti i lodhur fiton shpresë
në përmbytje

Terri thurë mjegullnajë ndarjeje
në largësi malli
Çaste vetmitare me kohën memece
 në kacafytje.

Do të ketë kaluar mesnata
Unë vazhdoj një yjësi frymëzimi ta krijoj,
Kë yllit kërkoj yllin tonë
Por ai ka thyer ligjet e fizikës
U shua posa shndërriti

(Sombor, mars 1981)

KTHIMI NË QYTET

Më duhej kjo mungesë
Që me mall ushtari të kthehem
Para teje të bie në gjunjë
Si në një klishe melodrame

Në mua ende ka zjarr
Edhe në takime koti shpërthen
Që ta ngjallë shpresën e ndryrë
Ti sërish përballë meje
Me shikimin e ngrohtë
Ti s'do të doje
Por rishfaqet dhembja
Nga plaga e fashitur
Dhe buzëqeshja e hidhur
Si me shigjetë helmi përbiron
Shpresën e humbur qëmoti

U çmallëm në hisen e shkurtër
të çastit që na u dha
çast i shkurtër si frymë
Më pyete për ushtrinë
Të pyeta për maturën,
Kurtuazi dhe gjakftohtësi e rreme
urojmë mbarësi në rrugët e ndara
ndjenjën e fajit ta pashë në sy!
dhe keqardhjen në lamtumirë

(Shkup, 1981)

ZBARDHJA E NJË DITE

Shikohem në pasqyrë
një çehre e zbehtë
dy sy të skuqur
E mollëzat pa gjak
Gjurmë pagjumësie
E ëndrrash të këqija

Një natë e kaluar kujdestar
Mbi linjat ushtarake
Cingërimat e rralla
Më zgjonin nga kllapia
Telefonat e jetës më venin në kllapi
E më lidhnin me trupat qiellorë
Me shëndrimën misterioze
Që magjeps

Një natë pa gjumë
Një luftë e pakuptueshme
brenda vetes
Fitoi lodhja
Dukem i mërzitur
Për çka?
Ç'ilaç të gjej
Për këta sy të zgurdulluar
Në qiellin pus

(Beograd, prill 1981)

DERGJE VARGJESH

Kur i thur për ty,
Vargjet dirgjen nga malli
Në letargji vitesh
Ti mbetesh cak i largët vargu

Kur i thur për ty,
Vargjet gjurmojnë
Të errëtat skuta
E shkoqasim të bukurën
E përjetësisë

Vargjet për ty janë të gjata
Si pritja e përjetshme
E një kthimi të pakthyeshëm
Të shkurtra janë vargjet
Si shpresa jetëshkurtër
Mbi varkën e shpëtimit
në turbullirë kohe.

Vargjet për ty gjurmuan
Brendinë e përmallimit
Të gjetën e të strehuan
Me kujtimet
Dhe vargu im gjurmon bukurinë
E drynuar në sekretet e përjetshme

(Beograd, 11 prill 1981)

NJË NATE TETORI IKA...

Pas meje jehon sinjali i telefonit
Dhe nevrikosem që s'të zura në lidhje
Asgjë të re s'kisha për të thënë
pas lamtumirës
Ndaj tash stacioni i zhurmshëm
me njerëzit që më përcjellin në tren
në sytë e mi është bosh
që as ngashërimi i ndërgjegjes
s'arrin ta zbusë fajin

Nata e shkuarjes ushtar kalon
Si një frymë
Çasti lamtumirës deh dhe magjeps
Unë po ikë me pushin e sapodalë djaloshar
një tren pret pasagjerët
në periferi të qytetit
Si një bartës fatesh
në gëzhojë hekuri
E diku larg në një qytezë
Rripat ushtarake më presin
Në këtë truall të njomur gjak
Me kthina historie

Por shumë ngashërim ka ndarja
Edhe trotuari edhe dritat e neonit
Edhe njerëzit më shikonin me mall

Pas më vjen zëri i gjyshes,
që dha grahmën e fundit
pakë ditë para se të nisesha
Telefoni që jepte sinjale
Biseda e pa bërë
Fytyra jote e brengosur në ndarje,
Shpresa në shikimet që u larguan,
Dhe një zë therës i ndërgjegjes
Më ndjekin tani
Në trans hapash
fshehtësitë gatuhen në kokë,
Me rropamën e çeliktë
Të trenit që më çonte në Sombor.

Atë natë tetori nuk qenë njësoj ndarjet
Qytetit i thashë Mirupafshim
Dhe ty Lamtumirë!

(Beograd, 19 prill 1981)

NJË TAKIM GJENERATE

Të tubuar gjimnazistët,
Një nga një përcjellin këngët,
Dhe evokojnë kujtimet,
Këngët valëvisin nëpër kohë,
Me jehonat e tingujve të ngrohtë
Ditën e bëjnë të stolisur,

Të thinjur, të rrudhur
Në sytë e mbushur mall,
Shikojnë prapa moshën shtalb
 në vitet që u ikën si fryma,
Shohim gjeneratat që vijnë,
Nga gjurmët e tyre në jetë,
Në këto karrige, banka e klasa,
Në këtë oborr dëshmitar,
kanë rrëfimet e tyre në skutat shkollës,
kur qëndisnin qiellin

Djemtë dhe vashat e dikurshëm
tash i kërkojnë faqet e grisura
me largësitë e kuptimeve,
që dikur janë dukur aq të paqarta...

(Prill, 1981)

MËNGJES I QETË

Virgjëri e struktur pranvere
Parqet përskaj rrugëve trandin vesën
Udhëtarët herakë ndezin veturat që me natë
Zonjat e vetmuara me zymbyl
Nxitojnë në vetëshërbim
për qumështin e freskët
E burrat e moshuar në syze,
Shfletojnë gazetën pasi del dielli

Nis ditë e re midis skeletesh betoni
Beogradi zgjohet nga gjumi
Përpëlit sytë në Sheshin e Republikës
Vetura e tramvaje kryqëzojnë rrugët,
Kalemegdani i shkrifton eshtrat porozë,
Sava e Danubi kanë harruar që po gdhin
Se vetëm punëtorët e turnit të parë
Dhe nxënësit e shkollave shikojnë orët

Beogradi zgjohet nga gjumi
Virgjëria pranverore
hijeshon buqetet e betonit
Me diellin ngjallet jeta
e qytetit zhurmëmadh

Duke pritur agun
Kuptoj sa i huaj jam pa ty
midis asfaltit e godinash të ftohta

(Beograd, 20 prill 1981)

STINËT E MOTMOTIT

Ditë e largët mbet,
Stinët e motmotit po ndërrohen
Herë thinjen bjeshkët,
Herë malet venë kurorë
Nw stinw vjelljesh
mollët mbledhin të kuqtë nektar,
Si shend në faqet tua
Si ëndërr e bukur e moshës shtalb

Ç'po ndodh me ne?
A ndërrojmë edhe ne me stinët?

Dita e e frymëmarrjeve,
Të zemrave që rrahin pranë,
të shpirtrave që heshtin,
Po ngel në qershorin
Që iku me maturën tënde
E druajtja për një dashuri bëhet obsesion
Dhembjen e fsheh pezmi
i mbledhur troç nga jeta,
Ti e quajte ditë fati atë ditë
Pranvera pat veshur qytetin në të blertë,
E ne mbyllnim një kaptinë,
Të një romani që as kish filluar

(Beograd, 25 prill 1981)

NË MESNATË

Kjo poezi lindi në mesnatë
Nga loja e pritjes dhe durimit,
Të gjatave përsiatje dremitëse,
Kur dhe hëna bjerr kohën kot si unë

Gjithçka është pezulluar
Qetësia e natës mbi qytet
mbulon ëndrrat e përgjumura,
vezullima e dritave i jep jetë
Qytetit që dremit në kllapi,
E unë dehem
nga çdo pamje
Që hyn nga dritarja,
Në këto orë të vona
Që lind mall
se dhe kur s'dua
fytyrën tënde shpërfaqin

Kjo poezi në mesnatë
tall kohën me shkarravina vargjesh
Nata është e freskët tek flas me ty
Në këtë boshësi qiellore
gjithçka ndaj me kujtimin
ca fjalë të thëna përngutë
Si pluhur i hedhur në sy

(Beograd, prill 1981)

MËRZI E PËRJETSHME...

Veje dorën në zemër
Rreh si orë vendimi
Një ritëm i çartur
Betejë me kohën

Le të mos kthejmë ndërmend
Gjërat që na pikëllojnë
Nëse beson në dashuri të përjetshme
pikëllimi vetë mund të kalojë

Vëre kokën mbi kujtime
Në përjetësinë e një bukurie
Hidhju në përqafim
Çastit që s'na takoi
një mbrëmje të qetë si heshtja,
Kur ujërat e lumit,
Shtojnë romantikën e puthjeve të njoma,
Në vend të lamtumirës

Tek ai bli gjethnjomë të mbetemi
Para ndarjes
N'atë qershor si pikturë e verdhë
Me lot të ngrirë
Për ikjen time nga gjimnazi
Ndonëse unë isha prekur më shumë,
Ndarja nga pragu i shkollës,
Ishte ndarje prej teje,
se tek të shihja te shkallët

Syri yt pat lëshuar lot
Që ikjes sime i jepnin motiv
Dashuri qe kjo, jo aventurë kot

Po ndahemi përgjithmonë, the në vete,
Po ikë nga jeta ime, thashë unë në vete
Si treni nga stacioni për të mos u kthyer,

Po ti e dije se ikja prej teje
ishte vetëm fizike,
kot do të pyesje
kush do të shkruajë vargje për mua,
Kush do t'më ndjekë
me shikime vjedhurazi
në autobusë pas shkollës,
Kush do t'u japë kuptim
Gjoja ikjeve të mia?

Me pikëllim e linde ndarjen,
Dhe pastaj ndjeva dhembjen
Për ty njomëzën e përmallur
Që me aq çiltëri më shfaqe dashurinë
Dhe pastaj me aq dhimbje ndarjen!
Poezitë më të zjarrta
Me çiltërinë djaloshare,
T'i fala ty
...
Të kujtoj tani si je ulur në karrige,
E menduar me shikim tëhu
që rrezaton një e dashuruar,
ah, sa psherëtima pendese në heshtje

Pikëllimi të bën më të dashuruar,
Si atëherë, si më vonë, si tash,
Me ty jam kur po i thur këto vargje
Për dashurinë e pranverës së kaluar
Sikur s'ka marrë fund ky idil
e kur të vijë me uniformë të kaltër,
sigurisht do t'më presësh
si luftëtarin tënd
që kthehet pas betejave

Rrembi më i bukur
do të jetë dashuria
Në vargjet e ushtarit
Për të mundur mërzinë.

(Beograd, prill 1981)

PAGJUMËSIA JOTE

Ti mund të jesh zgjuar sonte
N'tentim të ikësh nga vetëvetja
S'ke flatra, në dritare vazhdon të sodisësh
Si kallen-fiken yjet shpresëkëputur

Si as-herë kërkon dikë të vijë
Për një magji çasti
E s'vjen kush si për inat,
e di dhe ti pse
Trokama hapash të kthimit
Do të doje të dëgjosh
Për t'u ngushëlluar

Nata zgjatë sa pafund
As durimi s'shterë
Del n'ballkon gjysmëlakuriqe
Kujtimi gjallëron në kokë,
Qyteti fle si gjarpri nën gurë,

Me gjasë zhbiron kohën
Të bukurat kujtime-kyçur
në brazda të rrafshuara,
Harron se me të vjen
rrapëllima e trenit me piskamë
kur një nate tetori zgjidhe
dilemat e tua të njoma
kur nuk dole ta përcjellësh ushtarin
e gatshëm për në beteja për ty

Sodit terrin, çaste frymëzimi
tenton madje të thurësh vargje,
si atë tufë poezish që mi dërgove për kujtim
të vetme që kishe shkruar
Se mos kështu do të zbusësh dhembjen,
por, sonte dukesh si zogëz në shi
jeta s'është tradhtare,
vetëm njerëzit bëjnë mite prej saj

(Beograd, maj 1981)

PARA PASQYRËS

Fshive lotin nga mollëzat,
Në pasqyrë e vërejte pikëllimin dyftyrësh,
Një gurë nga zemra t'u lëshua,
Një rrugë qorre pendimi

Sa herë të kam shkruar
Sa herë s'më ke shkruar,
Sa herë të kam folur,
Sa herë ti ke heshtur,
Sa herë muri i ftohtë midis nesh
Ka qëndruar si midis zjarreve

Sa herë ecëm pranë,
Sa herë për dashuri folëm.
Sa herë heshtja bëhej kuptimplote,
Sa herë pikëpyetje venim në fund

Është një përditshmëri rutinë kjo tash
Pa afsh e drithërima

(Beograd, maj 1981)

ËSHTË KOHA

Është koha për të kujtuar gjëra të bukura
Ndoshta ëndrrat për t'i ftuar
Në gosti,
Atëherë e tërë bota bëhet e ime
Është koha të pushtoj
Labirintet e fshehta të ditës,
Do të jem i gëzuar për një çast

Është koha kur s'di si ta vras mërzinë
Apo frika nga zhgjëndrra
do t'më ruajë vetvetiu,
do t'më zgjojë vetë
Para se qoftëlargu sykeq i ëndrrës
t'më gulfat në ankth

Të pushojnë damarët,
Ta vë shikimin nën dry,
Është koha
Ta shtjerr muzgun,
T'i fsheh yjet pas perdeje,
Është koha të kyç parafytyrimet,
T'i përzë fantazmat
Kërkoj vetëm prehje,
Një gjumë të ëmbël
Të harroj për pak ç'ndodh
Me mua dhe rreth meje

(Beograd, maj 1981)

PEIZAZH

Trotuari është tharë pas shiut,
Era i thau edhe gjethet
U shterën pikat
si lotët pas ngashërimit
Vetëm era fryn e llastuar
Fut ethet në damarë
Mimika e mendimeve
pas ecjes mbi trotuar,
vetëm fekse parafytyrimesh
Parakalojnë në bebëzën e mërdhirë,
Gjithçka është konfrontuar
Sot në këtë ditë pa diell,
Kur era i thau pikat e shiut
Më futin frikën në palcë

(Beograd, 19 qershor 1981)

PËRVJETOR...

Po të të ftoja në ballo,
Do të vije ti në këtë përvjetor?

Eja, kaloi një vit bosh
Si të përfundojë ky tregim dashurie
Në gjysmë rrëfimi?

Ndjej mungesën tënde
Një vit i kotë i bredhjeve,
E bëra zemrën gur
Për t'u mësuar pa ty
Një valle bashkë, si askurrë,
Mund ta heqim

Prapë do të të përcillja
në dritën e zbehtë të hënës
Pas blirit ku fshihet ballkoni yt i heshtur
Parafytyroj si ecim përmes blinjve
Hijet tona në vals, pa muzikë
Si në një film surrealist

S'të gëzon aspak ky shpalim kujtimesh
E zhvarrosim fatin e kësaj dashurie
Më lehtë e bartim peshën e pendimit

Me lotët të vaktë në shi,
Mund ta kishim shënuar këtë përvjetor
Me lotë që shpërlajnë e derdhin mllefin
mbi trotuar,

Më ndje që s'bëra më shumë
Ndoshta duhej të flakja nga vargjet
E të të ktheja në botën e ftohtë
personazh përditshmërie

(Beograd, qershor 1981)

NJË PRITJE MERITOJ?

Doemos do të kthehem në qytet
pas një largimi të domosdoshëm

Kur të vij në qytet me hapa të plogësht,
Kur rrugët e qytetit do t'më sillen vërdallë
Kur si lëmsh do të ngatërrohen
me syrin tim,
Kur qyteti s'do të jetë ç'ka qenë,
E as ç'dua të jetë,
Dhe kur lagjet do t'i ruajnë
të njëjtat skuta të heshtjes,
Të njëjtat udhëkryqe dhe tollovi rrugësh,
Dhe kur prej autobusëve
do të zbresin udhëtarët,
Kur nxitueshëm trotuarit
do të venë gjithkund e kurrkund,
Do t'më duket qyteti tmerrësisht i shkretë,
Se do t'më vrajë heshtja në ballkonin tënd
Se në turma njerëzish do të mungojë
buzëqeshja jonë,
Kur silueta jote s'do të duket te stacionet
që ndaleshe dikur,
Asnjë gjurmë prej teje në këtë qytet të madh
Asnjë shenjë e jote
Ndaj i zymtë është edhe qyteti

Ku dergjesh me mallëngjimin?
Nuk mund të prehem
Vetëm duke shikuar fotografinë tënde
Në panonë e maturantëve
te "Foto Arena" n'Çarshi t' Vjetër
Dhe ta përshëndes buzëqeshjen tënde
të ngrirë e të përjetshme?
Do të mjaftonte vetëm kaq?

Meritoj më shumë se buzëqeshjen e ngrirë
Meritoj një pritje të beftë
Që kaherë pres të ndodhë

(Beograd, qershor 1981)

SOGJETAR

Nata më ngjan mua
e lodhur, me këputësi
Por një dëshirë e marrë
Vlon në damarë

Nata më ngjan heshtake,
me vello fshehtësish,
Përgjoj të kalojë koha me përtesë,
Pranë vazhdave nyje-nyje,
Ç'egoizëm?

Nuk di çka më shqetëson më tepër
Terri rrëqethës a vetja
dalë nga lëkura
S'di ç'role luajnë veç e veç,
Më neverit ky egoizëm i natës,
pres gjallërinë hyjnore të ditës së bardhë,
si lindje lehone të djersirë

(Beograd, qershor 1981)

BISEDË TELEFONIKE E PABËRË

Numri i telefonit në notes
më nxit t'i shpaloj gjurmët e ecjeve
Alo,
Në linjë I PAHARUARI yt
A je ti E PËRVUAJTURA ime
Dy fjalë desha t'i bëj, si me miken,
Ndonjë të pathënë të të thosha
për stinët që s'i shijuam bashkë

Alo, po të thërras ty, të përvuajturën,
Megjithëse lidhjet e këputura s'janë teknike
U ke vënë gardh rrugëve dhe shtigjeve,
Tani mbetet kjo dëgjuese magjike,
Që të të thërras ndonjëherë,
Të të pyes për hallet,
Për jetën që bën tash ku je
Si po kalon me ikjen tënde

Alo, e përvuajtura
Tani të përshëndes, mbetsh shëndoshë
Mirë që ta dëgjova zërin e ndërgjegjes,
Zërin therës që flet për heshtjen

(Beograd, qershor 1981)

LOT DHE SHI

Mund të mos kenë qenë lotë
Ato pika shiu në pikëllimin tënd

Në një natë me shi
Gjithçka do të dukej një
Dhe unë s'do të dija çka

Lotët dhe shiu
Do të jenë bërë një
Pikëllim në rigë shiu
Mund të mos kenë qenë lotë
Po vetë pika shiu në faqen tënde
Por në atë shi, mund të kish dhe lotë

Vetëm unë e di kuptimin
Se dhe lotë të kishin qenë
Mallin do ta kishin përzier me shi

Lotët dhe shiu
Vranësi e vrer bashkë
Për të fshehur kaosin brenda nesh

Ti ndoshta aspak nuk ishe e pikëlluar
Vetëm shiu vuri velin e misterit

Sytë e mallëngjyer të tradhtonin
Lotët ishin fshehur në pika shiu

(Beograd, 18 qershor 1981)

KAPTINË E MBYLLUR

Që në hapje kjo kaptinë,
Duket e përmbyllur

Brendia e saj është aq e qartë,
Çdo vazhdim do të ishte humbje kohe

Ndaj që në hapje
Personazhet thonë lamtumirë

Kjo kaptinë
Përfundon pa nisur

(Shkup, dhjetor 1982)

DRITARJA

Kaloj andej ku gjurmët heshtin nga bezdia
Trokëllima e hapave sillet vërdallë,
Në ikjen e turpshme nga fushëbeteja
Ku lë të dirgjen kujtimet me çastet marroqe
Që u ngjajnë njerëzve të lodhur nga mosha
Në çastet e luftës për jetë a vdekje
Ku caku i gjakimit është shlyerja
E gjithçkasë nga faqja e dheut
Gjurmë të mos mbeten

Kaloj andej ku dritaren e puth puhia
Në dhomën ku terri grindet
me bukurinë e ëndrrës,
Vogëlushja e flerë fshin lotët nga qepallat
Në kalim shikimi fluturon në atë dritare
Ku lidhen edhe udhëkryqet e shtegtimeve të mia

(Shkup, prill 1983)

PRITJE KOT

Kur arrita në stacion,
gjeta erën tinëzake
Që "fliste" çoroditur

A s'më le në shpresë se do të vije
Që më le ta ëndërroj i pagjumë
takimin që s'do të ndodhë kurrë?

Është orë e vonë,
Ora e Kullës së Sahatit
tregon një kohë të kaluar
Ku nuk jemi as unë as ti

(Shkup, 1983)

IDIL VERE

Në brigje detesh a lumenjsh
Mund të jesh dashuruar pa dashur
Jo vetëm për një flirt

Nis si aventurë
e pastaj mund të lind dashuria
Çiltër, pahetueshëm, përbirueshëm
Që zhvesh falsin e flirtit
me paramendim

S'ia del dot, prishet shema
ndryshe thuret balada
Gjuha e turpëruar nga qëllimi i ulët
Shndërrohet në vrull çiltërie
belbëzimë fjalësh në gjuhë të huaj
tradhtojnë qëllimin

Mikja e panjohur që të ndjell
N'këtë aventurë
pret princin në kalë të bardhë,

Fjalët zbrapsin donzhuanin,
Për ta gdhendur në vargje,
Nëse ishte princi që priste lajkatarja,
apo një bandill hajdut numrash
që n'fund me ndërgjegje të zgjuar
tërhiqet nga "beteja"
pa lënë vragë pendese

(Në anije rrjedhës
së lumit Dnjepër, 1989)

RUAJE ZOT

Do të duhej të isha i helmatisur
Një mllef që s'e zbuan stinët
Një pezmatim n'shpirtin çalë
Por dashuria
më ka bërë zemërbutë
ia kam falur kaherë
enigmën që s'e zbuloi kurrë

Është larg dhe s'ia them më
S'mund ta quash ndryshe pos bukuri
Është mëkat të lëndohet
Rrezaton magjepsje, vegulli
të verbër e të lumtur
mund të vdesin bandillët duke e ëndërruar
kudo që të jetë
ruaja zot bukurinë
mos e lë kohën ta lëndojë

Zot, ruaja bukurinë
I shkon me emrin
Ka emër ylli që i verbon njerëzit
E kam ruajtur përjetë në mendje
të pastër si vesë
mbi gjemba trëndafili

Mbetën të paprekur përjetë
Edhe vesa edhe trëndafili
Që egërsisht ndjellin bestytni
Për t'i tharë erë veriu

Ruaja zot bukurinë
Kur unë nuk e kam mëni
Ngrije kohën për të
Mos ia venit dhuntinë
Lere përjetë të verbojë bandillë

(Shkruar një viti të pashënuar)

HIJET NË TERR

Gjersa hapat tu të afrojnë te vendtakimi
Ka kohë që te bregu i lumit vras mendjen
Çdo takim është si një ecje në teh
Mbi humnerë dashurie

Një tufë laraskash fluturojnë mbi lum
Për t'më kujtuar fjalët e pleqve
Se laraskat në oborr sjellin sihariq

Vetëm unë gënjehem
në këtë takim të trilluar

DASMA NË KATUND

Tinguj dasme në mëhallë
Takte daulleje e zurneje
të ustave të djersirë

Duhma e dasmës
arrin gjer në qiell
Përshkon dhe fushë e ara
Të etur për ngrohtësi

Dhëndri i pispillosur ndër burra
Kujton në valle beqarinë
Edhe nusja ndër gra si fëllënzë
Në vete qan vajzërinë

Rrugë e rrugica
Hullinjtë e ugareve
Mbajnë mend ditën
Kur u bë nuse e bukura e katundit

daullet e zurnet
I bëjnë qeflli burrat në valle
Në aheng gratë bëjnë naze
Ritmet dramatike
N'valle t'grave e n'valle burrash
Hë për hë e lënë nën hije
ardhmërinë e çiftit të ri

POETI DHE TË HARRUARIT

Nëse ti je poet
Nëse ligjëron për jetën
Vallë din ç'është gurëthys?

Poqese i përshkruan ndjenjat
Për dashuritë e përdala të boemit
Din të shkruash për çekanin
Për dashurinë e një punëtori
Të kërrusur duke thyer gurë?

Që të shkruash edhe më tutje
E t'i thurësh vargje
Futu brenda në korridoret e shpirtit tim
Të ecësh me llambë minatori në tokë
Të mbetesh pastër
shkëmbinjve të nëntokës

(1979)

HIJE NATE

Natë është si çdo natë
Kur vras kotësinë

I heshtur vras kotësinë
E nga xhamat e kanapeve të dritares
Futen hijet e padukshme
Silueta pa kokë

Unë akoma përgjoj
Se mos vallë shkëputet
Ndonjë yll nga qielli
Që të bjerë, e të zgjojë
Ëndërruesit

Tingujt e këngës së shfrenuar
Prajshëm rrëshqasin errësirës
E para sysh shfaqen
Një mori siluetash me shapkë
Që lozin me hapa të çakorduar

I nemitur bëhem dëshmitar
Se nga silueta e largët e shkëmbit
Dielli del i shpërlarë

(Shkup, 1983)

TY-TY- TY...

Trumbeta zgjon ushtarët
Që flenë të lodhur
Diku në mes të xhunglës në mision

Ty-ty-ty
Në veshë lepurushi
Për helmeta ngjyrë plumbi
Një sinjal se fillon
Misioni "fisnik"
që kryejnë në dhe të huaj

Bashkë me ta
Zgjohen edhe lumenjtë
Edhe bari i njomë
Flejnë gjarpinjtë dhe bretkosat
E me to lozin hijet
me bisht majmuni

Në mes tyre padiktueshëm
futet dhelpra alpike
për t'u ftohur gjirin e zjarrtë
ngrohur nga tymi

në xhungël dhe luftë
vlejnë tjera ligje
Ty-ty-ty
Thërret trumbeta helmetat e flera
Dhe zgjimi i tyre nga ankthi
I çon drejt nga humnera

(Shkup, 1983)

JETË E RE

Asnjëherë s'e kisha lodhur veten
Me pyetje "të rënda":
Si është çasti i parë i frymës
Çfarë ndjenje është të përjetosh
lindjen e jetës
Si është jeta para jetës
I robëruar në barkun klaustrofobik
Dhe çfarë është jeta
me frymë të pavetëdije

A mund t'i gjejë përgjigjet një fëmijë
Kur as vetë s'di si ka ardhur në këtë botë?

Asgjë s'dija gjersa një ditë
Nuk "e sollën në oxhak lejlekët"
Një vëllath "të shëmtuar"
Q'e pashë tek e lanin gratë në legen
Tek ia prenë kërthizën
që e hodhën në plehun e lëmës

Lejlekët sjellin fëmijë
Po, po, gjithandej fshatit sillnin
Kështu lindka jeta kujtoja
Me logjikën e 4-vjeçarit
Kur s'dija asgjë për spermatozoide e vezorë,
Për fryte dashurie të devotshme

PO TË MOS ISHE TI

Bridh pas ëndrrës, kërko muzën
E Bukura të ndjell dhe ikë
Vrapi s'ndalet, ajo ikë si hija
Gjithnjë dy hapa para
Një lajkatare "e lindur"
që ka mësuar lojën e flirtit
Dhe shfaqesh Ti
Pas shumë kthinash

Je më e bukur se E Bukura
Je e Bukura e Dheut vetë

Ti nuk bën lajka
Ti nuk më le të përmallem
Por të çmallem
je si rëra që s'e merr lumi
je ajo që mbetesh
përjetë

gjithnjë pranë,
ti vetë mund të vuash
dhe të heshtësh durueshëm
që të mos lëndosh

Në lagje fqinje do të kemi jetuar me vite
Do të kemi kaluar shpesh pranë
Si të panjohur dhe pa u parë!
Vetëm kur je shfaqur pahetueshëm

Më është fshirë gjithë kujtesa
Histori të kaluara në kohë të zverdhur i lamë
Një magjepsje që ka lindur ngadalë
Si në kohë tjetër dashuri e parë
Vetëm koha ç'rëndësi ka
Koha dhe mosha pështjellim krijuan
Rreth e rrotull i çuan shtegtimet
Gjersa s'rastisëm në një vend,
Si në çast "të shkruar"

Pastaj jeta na bëri bashkudhëtarë
Dhe bashkëluftëtarë
Nga beteja në betejë
Një strofull për ëndrra
të kemi

Dy lagje fqinje na kishin ndarë
Dhe ndonjë çik kohë shpërputhje ecejakesh
Ndoshta nuk ish' gjithçka si në përallë
Ia kemi mësy' jetës
Gjersa të thinjem, gjersa të plakesh

Po të mos ishe ti
Kushedi në ç'kohë e hapësirë
Do të prisja të shfaqej
E Bukura e Dheut
me fytyrën tënde

Cikli:

PLAGË TË MOÇME,
PLAGË TË REJA

FATI I SHERBËTORËVE TË PERANDORISË

Emrat s'ua gjen në kronikë
Veç në kujtesë të familjes
Shërbyes të devotshëm të Perandorisë,
Enigmë e pazbuluar
Rexhepi dhe Feleki, at e birë
Me emër e nam n'Dërven
Q'i përpiu kohë e turbull

Zoti në qiell, Sulltani në tokë:
Një Krijues qiejsh e botësh,
Që falë frymën dhe udhërrëfimin
Një perandori tokësore
E denjë për t'iu përulur

Sulltani, "veqil i Pejgamberit"
Dhe "zot i gjithë botës"
mjerë ai që i shkel në bisht...

Një shekull e gjysmë më parë n'Rumeli
Pre thashethemesh shumëkush ra

Gratë e katundit mbushnin ujë dhe
T dhe flisnin në vesh,
të mos dëgjojnë muret
Të brengosura për burrat e tyre:
"Dovleti ka sjellë ferman,
Aman o Zot ç'do të dalë?"

“Në ka dalë ferman, ka orman!”
Kishte thënë plaku Rexhep Bylykbashi,

Dy të parë të mëhallës Logri
Dy bajraktarë të Bojanës
Grykën e Dërvenit vrojtonin
në mos kush ua sjell fermanin
kushedi ç’gjëmë do t’sillte

Një ditë nuk erdhi fermani,
por një ftesë nga Stambolli
“E shihni, kot fjalë,
Vetëm armiqtë e Perandorisë flasin
Se fermanët janë dhe për të mirë”.

Shaluan atin bylykbashët
Dhe shkuan
Në një festë të madhe
Për një pushkë të re të askerit
Një pushkë për armiqtë e Perandorisë.

Shkuan dhe s’u kthyen më!
Ç’u bë me ta në rrugën për Anadoll?
I vranë cubat e maleve?
I vranë armiqtë e perandorisë?
Apo i vranë në tradhti
si krerë të tjerë
gjithnjë kur Padishahu
dyshonte në murtatë?

Shumë pikëpyetje ngelën trarëve të shtëpisë
Ç'mëkat kishin bërë q'i mori në hundë dovleti?
A ishin shërbyes besnikë të Padishahut?
A ia kishin turbulluar ujin ndonjëherë?
Apo kishte ndonjë mëkat tjetër?
që veç dovleti e dinte,
Nga ato mëkate
që veç nga i madhi Zot
S'mund t'i fshehësh?

Familja, mëhalla, katundi dhe tërë krahina
I qau bylikbashët që mbetën pa nishan varri
ç'faj ua hëngri kokën, askush s'dinte
mbeti dyshimi se diçka po ndodh
Perandorisë i kish hyrë tërfili i vesveses
s'dallonte më si një plak në dergje
kë ka armik e kë shërbyes të devotshëm
Do t'i dalë tymi, do t'i dalë, thoshin
Do ta zë haku Padishahun
I rëndë është mëkati të dyshosh pa faj

Shkroi Brahimi, nipi te Krosët e Raçes
Se bylykbashët ngritën krye me Dervish Carën
Po gjërat s'përputheshin as në datë, as me nishane ngjarjeje
Ngjarja dukej sikur t'u qe prerë koka në Manastir
Por s'përputhen vitet as me të,
Të ketë ngjarë me Tanzimatin,
Ç'ne reformat me vrasjet e bylikbashëve.

Shumë enigma ka historia e pashkruar
Kujtesa e pa shkruar i përzien vitet dhe ngjarjett
Brez pas brezi u përcoll rrëfimi
me shumë pikëpyetje
Gjithnjë duke vrarë mendjen
Cili qe mëkati i shërbetorëve të devotshëm
të Perandorisë
Që pa ia kthyer pushkën
Ishin vënë para tytës me hanxhar

Bylikbashët e familjes i besuan përjetë
Drejtësisë së të Madhit Zot,
I kishin besuar dhe Perandorisë
Që kujdeset për drejtësinë në tokë,
Shkuan dhe s'u kthyen
Nga Manastiri a nga Stambolli, kushedi
Kushedi në grahmën e fundit
a zbërthyen urtësinë e jetës
Se pushteti ka tjetër "jazi" drejtësie
Ku dyshimi është mëkat
më i madh se vetë faji

KTHIMI I HASAN PRISHTINËS NË SHKUP

Në kohëra të mbrapshta të doli nami
Ndonëse nuk të shkruan lavde
S'ta kishim kuptuar vizionin
Apo se harresa mbulon pa të drejtë
Njerëz't e pushkës e t'mendjes?

Të kish filluar shekulli
me një mision të pakryer
Me mallkimin e të padëshiruarit
Në atdheun e ëndërruar
as trokitjet nëpër kancelaritë e Evropës
Për të gjetur gjysmën e humbur
Nuk të sollën shpagim shpirti

Një shekull pas zbrite sërish ndër shqiptarët,
Për t'ua hequr pluhurin
shanseve të humbura,
Për ta rimarrë veten
nga krenaria e mëkëmbur
Që ta morën pas vitit të kometës,
Kur mbretër e kryeparë të Atdheut
Lindnin si kërpudha nga shiu
dhe shuheshin si meteorë
Dhe shkonin nga historia
Si heronj pa mision të kryer

Ta kuptojmë tash
më shumë se kurrë
vuajtjen e "njeriut të huaj"
se ç'të mundonte
Kur shikoje shumë kryezotër
Që s'e bënin dot atdheun Një
Grindavecë, kokëfortë e të paudhë
Aventurierë e mercenarë kauzash
Tregtarë flamujsh[4]
Qenë shtuar në tokën e arbërit,
Kundrejt teje që kishe vetëm një hartë
Të skalitur në ëndrrën që s'vdes

S't'u ndanë flijesat për kauzë
Kundrejt paudhësive të historisë,
Njëqind vjet pas të sollën në bronz
Në Shkupin tënd me frymë atdheu
Ku shkrive florinjtë e familjes
Në themelet e Një atdheu të plotë
Sot historia është më e drejtë për Kosovën tënde
Një gjysmë atdheu që të shkaktoi atëherë
Lëngatën e pashëruar të ëndrrës

(Shkup, 2012)

[4] Titull tregimi nga Ernest Koliqi

RRËFIMET E HESHTURA TË XIMËS

Historia shkruhet me kalem
Por krijohet me eshtra dhe gjak
Me ushtri e martirë
Që ecin a mbesin të paemër
N'marshe fushëbetejash

Nuk e kisha dëgjuar të flasë kështu
Daten Ximë,
Një hyzmeqar dikur
Që e kishin bërë zot
Pleqtë e familjes,
Kur i dhanë arat

Po ai, Xima i Dates Cil,
I mobilizuar në fund të luftës
Gjithë jetën heshti si nga turpi
Për luftën që s'e bëri kurrë

Kur luftëtari hesht
një luftë që s'shihet
Q'e heshtë me zor
Sa një jetë

E vërtetë është siç flitet,
Shumë prej jush i vranë pas shpine
Në Tivar?

E vërtetë është që u vrau "shkau"
Në pritat e rrugës?

E vërtetë është që në luftë shkuat
Me opinga dhe duarzbrazur?

E vërtetë është se n'Tivar
s'u vrau veç shkau
Po dhe nga partizanë t'Enverit
tek kalonit nëpër Shkodër?

E pyesnin Ximën
q'e kishin mobilizuar '45-tën
Për të ndjekur gjermanin
kur të gjitha luftërat menin botës

Shkoi me zor e u kthye kokulur,
i heshtur sikur të kishte bërë benë
të mos flasë kurrë me askë
të fshehtat deshi në varr t'i merrte

Kur e kërrusi mosha e luta ta thente benë
I thashë se më e fortë se beja është borxhi
Çdo dëshmitar i ka borxh historisë
i thashë se komunistët kanë rënë më nga pushteti,
kanë vdek' Tito e Enveri, s'ka më partizanë
që do ta venë para pushkës
" O Ximë, më thuaj ato që s'i ke thënë,
Ç'ke parë me sy,
ia ke borxh historisë
por dhe lehtësohesh nga barra,

me t'vërtetën e mbrujtur
sepse tashmë është shkruar
për masakrën e Tivarit!"

Xima hapi zemrën e drynuar:
"Pasi historianët paskan shkruar,
Rrëfimi im nuk ka më vlerë
Nuk di si mbeta gjallë
N'gjithë ato tyta e prita
N'gjithë ato hendeqe e dete
Dikush kish vendosur
Ca të vdesin e ca të mbeten
Me frikën e mbjellë përjetë në bark
Që të heshtin përjetë
Ç'kam parë e përjetuar,
Qofshin të harruara,
Kam parë si njeriu bëhet bishë,
Si ideologjia vret shpirt njeriu
e shkel mbi njerëz
si të jenë buburrecë,
Bisha e zhbën edhe sojin e vet
Ndjeja turp që isha njeri,
Çka të flas më shumë,
Dhe unë zgjodha heshtjen kur s'dëgjohet zëri,
N'sistem të të vërtetave të shpifura
Vetëm të vërtetën s'mund të flisje!".

KUR BABAIN E LODHI JETA

Ç'po ndodh kështu me mua,
Që dhe shkallëve kur zbres
T'më merret fryma!?

Një hipje e gjatë
Dhe një zbritje me frymë pak
Ditë e Gjykimit po më thërret

Iu afrua të tetëdhjetave,
Dyzet vjet jetoi në qytet
I ndjekur nga malli
për dyzet vjetët tjera
në katundin e lindjes

"Pse s'ndan pak kohë,
Ti je gazetar, ke shkathtësinë për të pyetur
Më shumë se ç'mund të të përgjigjem,
Për idealet që na lajthitën
Kam shumë për të folur për gjyshërit,
Për axhën tim që ra fli
për "Shipni a gur e hi",
Për Titën, Enverin, Stalinin, Amerikën
Që ndikuan në jetët tona,
Pyetmë, se një ditë do të pendohesh
Për kohën e kaluar kot
Pranë t'et!
Shumë rrëfime të fjetura,
Në kujtesë dirgjen të pathënat

Vetëm duhet trazuar
si vrerin
Që t'i "vjellë"
Isha dëshmitar në kohë të çuditshme
Nga e shkuara mëson
si bëhet ardhmëria"

Kështu fliste babai
gjersa unë për pagë shkruaja
Gjërat triviale për gazetë
Duke thënë me vete
Se një ditë do të ulem t'i shkruaj
Të gjitha kujtimet e babait

Një ditë beftas e çuam në spital
Humbi vetëdijen dhe nuk u zgjua më
Me frymën e tij të fundit
Mori të gjitha pyetjet e pabëra
Dhe përgjigjet e pa dhëna

Më mbetën t'i përmbledh kujtimet e tij
Nga dromca rrëfimesh ndër vite:
Për Xhaxhanë që e vranë "të kuqtë"
I ri ra fli për kauzën e tij
emrin ia përtërinë në mua
për ta kujtuar në jetë të jetëve
Për mësuesit nga Elbasani
që mbollën dijen në kohë ters,
Për lajthitjen e madhe të komunizmit
Që kishte shpikur besim
q'i jepnin dënim me vdekje Zotit.

Për NDSH-në kishte folur,
si për shpresën e humbur
Për ikjet për Turqi a kurbet më vonë
Për pse-në që ai u bë që i ri plak katundi
Për besimin që kishin te regjimi i ri
Dhe dëshpërimet prej hileve të tij
Kishte shumë tema me ngjyrime kohe
Që prej tij a burrave tjerë
Ishin treguar në oda

Të gjitha rrëfimet
do të kishin qenë më jetëplota si memoare
me kontrastet e familjes
ku xhaxhallarët kishin "vullnetarë"
e nipi komunist i dëshpëruar
që të vërtetat i njohu vonë
kur vdiqën prijësit e kuq

NJË JETË NË MËRGIM

Lotët e familjarëve si në mortë
Ia çorrën zemrën si me thikë
Edhe pse pas shpresës iku

I kujtohet si sot, një botë tjetër
Ishte perëndimi,
Qytetet, fabrikat, magjistralet,
S'gjasonin me fshatin e lindjes rrëzë malit
Por atje njofti fytyrën e mallit
Mallëngjimi për ata që i la
Për dheun e vajit të parë
Ku në djep ia kishte ënda
Ta mashtronin me pralla dragojsh
si në thera qëndroi vitin e parë,
Duke kujtuar ditën që të kthehej,
Pak nga pak mësoi gjuhën e huaj,
Fitoi para sa për dhjetë vjet bereqet
nga arat djerrina
I dërgonte kryeplakut të shtëpisë
Të bënte shtëpi, dasma e fejesa
Një ditë dhe ai do të kthehej.
Përgjithmonë.

I bën dhe dasmë të madhe
Për bollëk sofre e aheng me daulle e defe,
Nusja që mori mbushi shtëpinë me gazmend
S'ishtë më jetë e arnuar

Vendosi të ikë përsëri
një thes tjetër me para të sjellë
dasma vëllezërve t'u bëjë
shtëpi të re me ornamente e stoli
të ndërtojë

Nuses i premtoi se do të kthehet shpejt,
Për aq sa të plotësojë ëndrrën e tij
E pastaj të lumtur do të rrisin fëmijët
Gjersa të plaken

I kujtohet se u kthye kur i lindi djali,
Kur puthi të birin dhe nusen
që i kish dhuruar trashëgimtar,

...
Shumë krahë pune ikën nga fshati,
Ca rrinin në gurbet,
ca ktheheshin duarthatë
S'ishte fati i njëjtë për të gjithë,
Por dhe ai hyri në shtegun
e shkuarje - ardhjeve,
Çdo vit të ri "edhe sivjet, dhe boll më"
i thoshte me gajret vetes
Sa të rregulloj këtë, sa të rregulloj atë...
Dhe nisi të vijë rrallë e më rrallë,
Gruaja priste te lëma
për t'ia parë veturën kur vinte rrallë
E fëmijët lakmonin
valixhet plot peshqeshe.

Dalëngadalë u bë mysafir i shtëpisë së tij
Fëmijët e përjetonin si një xhaxha
që u sjell lodra e çokollata mërgimi
Edhe ikjet e tij u bënë më të normale
se kthimet

Dhe një ditë i mori dhe ata
Dhe kthimet humbën kuptimin
Në shtëpinë bosh.

SHTEGTARË TË BOTËS

Kam hipur e zbritur në shumë aeroporte
Ku udhëtarë të racave të botës
Vrapojnë pas kohës së fluturimeve
Asnjëherë nuk vras mendjen ku shkojnë
Janë shtegtarë të botës
kërkojnë fole të reja
e dinë vetë përse ikin prej dikah
dhe ç'kërkojnë diku tjetër
edhe kur e dinë se ç'kanë lënë pas
zor ta gjejnë larg gurit të shtëpisë

Në këtë rrëmujë udhëtarësh
Ca si shumë pasagjerë flasin që flas unë
Mund t'i dalloj edhe për nga fytyra
lëkura e rreshkur
Në Evropë është stacioni i parë
Nxitojnë t'shkojnë në vendlindje
Për të shuar mallin
Që me vrap të kthehen
N'syrgjyn përjetë
Larg syve mbeten arat
Nga u shkulën një herë
Nën hije kumbullash
mbeten varret
me kujtimin e t'parëve
Shekulli Njëzet shembi iluzionet,
Një popull pikë e pesë
S'i zënë më kontinentet,

Ca ikën nga ideologjitë terse,
Ca nga arat shterpe,
Ca nga që s'patën strehë

Gjetën bukë e pallate,
Me marka e dollarë të krusmës
ushqejnë familjet e mëdha,
Ndanë nga goja dhe për luftërat
Për të sendërtuar vonë Ëndrrën
Liria u erdhi gjithandej
Me gjak e djersë e larë

Tash mund t'i kthehen vetvetes
Dhe kohës së mërzisë
Së përmotshme n'egzil
Aeroplanët duken më të lodhur
Se trenat kur trokëllinin rang-dang
Me pasagjerët që iknin natën
për Anadoll
Se janë lodhur nga udhëtarët
që flasin një shqipe të përzier me gjuhë Evrope
Se s'iu ndalën brengat e jetës,
Ndonëse shëruan ca lëngata të vjetra,
Ca të reja n'dhe të tyre
s'i lënë të prehen

Fluturojnë se s'i zë vendi vend,
Asgjëkund
Si rrënjë të shkulura,
As mbillen në vendin ku kanë le',
As bëjnë fryte në tokë të re.

MOSHA E JETËS

Rum-dum, rum-dum
Një daulle në dasmë të huaj
S'jam më i ri, s'isha asnjëherë i valles
Por se ç'më vjen në këmbë,
Një shtysë nga brenda
Të bëj t'pabërën në rini

Të kërcej në ritmin e daulles
Rum-dum, rum – dum - dum
Se ç'më vjen në këmbë
Me vitet që ikin pabesisht
Ku isha e ku jam
N'këtë dasmë të huaj

Kërcimet e jetës si në ritmin e daulles
Rum-dum, rum-dum-dum
Si në vorbullën e historisë
Me zigzake e kthina
Ç'është mosha jonë
në jetën e përmotshme

ÇAJTORE NË MES TË EVROPËS

Një qytezë e vogël, në zemër të Evropës
E tymosur "Çajtorja e Taxhës" në Huj[5]
I ngjason çdo çajtoreje të Bit Pazarit
Me fytyra sikur i ke parë diku
Sikur janë fqinjët e parë ose tezgaxhinj
Të ulur në çajtore për një pauzë

Në rrugë të Evropës
Dergjet një Bit Pazar më monoton
Se në Shkup

Mërzinë dhe mallin për vendlindjen
E shterin duke pirë çaj Cejloni me limon
Tek qahen për vizat që s'ua japin
Duke i ngrehur për hunde avoketë
Me premtime sot a nesër

[5] Huj, qytet në Belgjikë

Këtu të papunë, në vendlindje të papunë
Por thonë nuk është njësoj,
Në Evropën e krizës megjithatë
ka më shumë shpresë
se në arat e shpërndara djerrë

Të dëshpëruar nga çdo ditë e kaluar
Sytë i kanë kah e nesërmja
dita e re mos u sjellë nafakë të re

(Belgjikë, maj 2012)

PËRSËRI PO QESHEMI NE

(Tekst kënge)

Një botë të ndryrë e lamë pas
Hapa sytë, se s'kam fuqi të ngas
Ndoshta s'jam ai që më njeh
Pas shumë vitesh përsëri më sheh
Ndoshta s'je ajo që të di
N'shikime t'vona je një mrekulli

O, hije e bukur në nur
Si rreze dielli mbi re,
Shumë stinë u bënë urë,
Më në fund po qeshemi ne.

Këto vite që hape plagë,
Vjen e bukur, vijë e vragë,
Më i fortë se ky mall ndjej
Hap pas hapi po më ndjek
Të gjitha shtigjet çojnë kah ti
E Bukura e Dheut, moj perri

KËNGA PËR REXHEP DHE FELEK LOGRIN

(Variacion për këngë rapsodike[6])

Ka shku haberi në Stamboll
N'Rumeli po zien si n'kazan
Ka çu kokë raja, po thotë "boll"
Boll n'robëri, duam vatan

Në Stamboll pyet sulltani
"çka do raja, ky milet kryelartë?"
Po a nuk është i juaj vatani
Gjithë vezirë e pashallarë?

Gratë n' Bojanë te bunari i Karaxhës
mbushin shtambat dhe kuvendojnë
Fjalë burrash, gajle t'dynjasë
Se Sulltani do t'qesë ferman
flasin gratë nëpër mahallë
burrat do t'na i bëjnë kurban
fjalë t'këqija i kanë shku dovletit

---

[6] Disa tekste për këngë popullore, të shkruara me porosi, autorin e futën në grackë gjuhësore, duke bërë përzierje të panatyshme por të imponuar (të ndikuar) nga trendi: as gjuhë letrare, sepse këngët popullore vazhdojnë të këndohen në gjuhën popullore paçka se jo të identifikueshme gjithherë me trevë të caktuar, as popullore, sepse nuk ke një të folme popullore në të cilën shkruhen këngët. Përdorimi i fjalëve nga një mjedis specifik si Dërveni i Shkupit, ka qenë minimal sa për t'i dhënë ngjyrim identifikimi. Përziera është bërë nga spontaniteti…!

Nga aspekti përmbajtësor, te disa këngë me motive nga e kaluara, është ruajtur konteksti historik, i cili mund të jetë përjashtues me realitetet e mëvonshme të krijuara pas ngjarjesh e procesesh të mëdha shoqërore e historike…

se pas shpine po i punojnë shtetit
perandori e madhe, n'katër anë
me din e iman, me yll e hanë
t'lujnë me shtet askend s'e lanë

Rexhep Logri i thotë djalit
O Felek, bir hasreti,
Rri rahat se i biem malit
S'na ka marrë mëni dovleti
Por n'ka dale katil-fermani
ja ku asht fusha, ja ormani
perandorisë i kemi shërbye
kurrë fjalën s'ia kemi kthye
por vjen koha kur s'shkon ma
vjen koha edhe me u nda
gjithkush të ec n'rrugë të vet
sikush zot në shtëpi të vet

2.
Por nuk doli kurrfarë fermani
Një ditë ftesa erdh n'katund
Bajraktarët po i thrret sulltani
Gajlet e dovletit nuk kanë fund
N'Manastir gjithë ata krerë
Një gosti do t'u shtrojë për nderë
Sy në sy me krejt me u pa
Me qa hallet, ndash me u sha
Se po lujnë fjalë ndër hafije
Raja e qetë don me çu krye

Por pushkë të re ka nxjerrë sulltani
Që t'mos ketë më gjumë dushmani

3.
Udha e gjatë nuk ka vade
Mbushin strajcat, me hangër me pi
Nuk e dine çka i pret nëpër male
Dhe n'Manastir kur kanë mbrri
Në kazermë i presin me "mirësevini"
Gjithë çka keni, këtu i lini
Pa teklif jemi, të huaj s'ka
Gosti me mish, e bakllava
Se pashai ju mirëpret
Të kuvendojë me miq të vet

4.
"Çka po ndodh, kush po na gostitë
Diçka nuk është si duhet me qenë
Seç po m'duket sikur pritë
Po na kqyrin si me qenë dhen"
Rexhep Logri i fol djalit
Burrë kuvendi, një jetë përvojë,
Për mysafirë një batare n'hava
E rreh mendjen mos është lojë
Por askeri pushkët poshtë i zbret
Nga bajraktarët marrin nishan
"pushka e re" sa mirë po qet
"Këta, babë, po na bëjnë kurban!
Ky dovleti na preu n'besë
Kjo është grackë, s'ka më shpresë"
Babë e birë kujtuan fermanin

U dol punë me dushmanin
S'patën rusat as n'fyt me iu kcy
Punë dovleti që s'e merr vesh
U prenë në besë, u tradhtuan
Ranë për tokë hiq pa u përlesh'
A thu' kot këtë jetë e çuan
Rend tuj mbajtë në Dërven
Tuj rujt karvanet nga cuba mali
Hakikat e kishin qit' n'dyzen
Por në fund s'ju eci falli
Porta e madhe i kish marrë n'sy
Se s'lejon ortak sulltani
Veç një mbret n'perandori

NJË VARR PËR TRIMIN

(*Tekst kënge rapsodike për Daut Sulë Felekin* (1913-1944)

1.
Nga paria urdhëri është marrë
Nga çdo shpi, një vullnetar
Sherr te Logrit, v'lla me v'lla
bukë në sofër askush s'ha
Kush në krah pushkën ta hedhë
"Bijet" armikut ia kanë mbledhë
Flet Ramizi, "jam ma i madhi,
E kam hak të prij i pari!"
"Jo bre vlla, ruj' oxhakun"
Thotë Naipi, i vlon gjaku
Merr janxhikun, n'vrap si era
Por Dauti i del te dera
Dhe në krah e hedh mauzerin
"A mos don t'ma marr'sh exhelin!?
Boll luftove në shumë beteja
Tash mu' fati më thërret "eja!"
Një shej t'bukur pashë në andërr
Isha veshur porsi dhandër
Do të shkoj me këmbë të mbarë
Dikush n'mal, e dikush n'arë
Këtij dheu i kem dhënë besë
kush me pushkë, e kush me këmesë
Këtë e di edhe ti nëna ime
S'thehen prangat (e robit) pa flijime

(REFREN)
Ky Ballkan s'do t'jetë i qetë
As në botë s'ka rahati
Se një ëndërr, e kem për jetë
Ja Shqipni, ja gurë e hi!

Foli nana "Lum që ju rrita,
Ruani plisat nëpër prita
e për ne mos qani hallin
mbushet shpija plot me djepa
I rris nipat, ma heqin mallin
i bëj burra, i rris si plepa
nga dushmanë ka hjekë ky dhe
k'ta "moskova" janë t'pa fe
n'tokën tonë të jemi zot
e kem' njomur me gjak e lot
shkoni djema, ikni trima
toka jonë është si fryma
e pa frymë nuk ka jetë
si rrjedh lumi n'shtrat të vet

2.
Nga Bojana shumë vullnetarë
Me Dautin si "krushq" kanë dalë
Të "kuqve" rrugën me ua pre
T'mos bëjnë zullum këta t'pafe
Në fushëbetejë po hidhen trimat
shkrepin zjarr si vetëtimat
n'shtab armikut i kanë hy
fyt për fyt, po bëjnë kërdi
buçet pushka n'tokë e n'qiell

që t'na ngrohë më fortë ky diell
Që me shekuj na e kanë terru'
Votrat tona tuj shkretu'
Se nuk vjen më kohë ma e mirë
N'votrat tona të jemi t'lirë

(REFREN)
Ky Ballkan s'do t'jetë i qetë
As në botë s'ka rahati
Se një ëndërr, e kem për jetë
Ja Shqipni, ja gurë e hi!

3.
Dhe kur çeta lugut ka zbritë
N' Breznicë t'Shkretë bie në pritë
Me breshër plumbash janë goditë
Por nga Dërveni janë k'ta trima
Tuj luftu s'u ndalet fryma
Kush më shumë e don këtë dhe
Me mbet gjallë, mos me ra pre
Kanë dalë t'gjithë për ideal
N'dash dhe eshtrat me i lanë n'mal
Dhe Dautit iu morën këmbët
Merr tërnak, i shtrëngon dhëmbët
Sejda i Etemit e merr n'shpinë
Por rafalet prapë i binë
Në damarë gjaku iu ka mpi'
një perde e zezë i bie n'sy
që t'ecë para forcë nuk ka
Fjalët e fundit amanet i la:
"E uruar do të vijë një ditë

Si pranverë që sjell freski
Që me shekuj e kem' pritë
T'jetojmë t'lumtur në liri
S'u shua kot kjo jeta ime
m'prehen ëndrrat n'tokën time"
Sefa i Logrive iu gjet pranë
E mbulon kushëririn me marhamë
Ia drejton kryet nga perëndon dielli
Me shikim t'fundit drejt kah qielli
Mbet Dauti në fushëbetejë
vdekje e bukur, n'moshë rinore
Do t'panjohur e fusin në dhe
Që t'pushojë në tokë arbnore

(REFREN)
Ky Ballkan s'do t'jetë i qetë
As në botë s'ka rahati
Se një ëndërr, e kem për jetë
Ja Shqipni, ja gurë e hi!

4.
O trim Daut, i fortë si lisi
Ku ke vorrin ku t'ra plisi?
"Jo s'më preku askush n'ballë
Po m'ranë prapa, si qyqarë,
Varri im është pa nishan
n'dheun tim kudo jam
n'ajr e n'tokë, n'ujë të d'lirë
Fryma ime është e lirë
I kam veshë gjethet e malit
Jam i lirë si n'shalë të kalit"

5.
E di, motra, ju kam përvlu'
E desh fati të vdes i ri
nusen time me ma ngushllu'
Edhe nanës lotët me ia fshi.
Djalin n'djep puthnja për mu'
Se përjetësinë e kam përqafu'
Ju rashë pas t'parëve t'mi
Që dikur i prenë n'tradhti
Të mos na shtyp më askush ne
as krajli, as "moskovë" t'pa fe

(REFREN)
Ky Ballkan s'do t'jetë i qetë
As në botë s'ka rahati
Se një ëndërr, e kem për jetë
Ja Shqipni, ja gurë e hi!

I PLAKUR NË GURBET

(Tekst për këngë kurbeti)

O sa e pa mëshirë na qenka jeta
sa shumë shpejt ma mori rininë
po ma t'randë se gurbeti s'gjeta
dhe me vrap ma soll' pleqninë
n'dhe të huaj ta gjejmë nafakën
boshllëkun n'zemër na e ka shtu'
erdhëm të rinj, tash u mplakëm
s'është kjo jeta që e kem andrru'

Kjo pleqnia tash m'ka zanë
rri në breg t'Rajnës çka s'm'kujtohet
m'hidhet zemra gjithçka me lanë
n'katund tem prapë të kthehem
n'ato ara prapë t' shpërgjehem
me e ndje veten prapë i ri
n'shesh t'katundit prapë me dalë
n'valle t'darsmave prapë me hy
me hip n'daulle, me allti "me e kallë"
me knaqë shpirtin, zemra me u shkri'
shkoi mosha, mbetën veç kujtime
veç një ëndërr kjo jeta ime

...
Mor' gurbet, shumë luks na dh(a)e
por pa shend e gzim, pa shpirt na l(a)e
ndaj n'katund prapë du me u kthy
të shetis n'Miraze, n'Zheden me dalë
t'luj filxhana, n'odë me kcy
me e pa fushën, me u çmallë
këmbryq me u ulë në postaqi
kangëve t'vjetra me ua krisë
t' minxhës Imer e t'puçes Hisë
dhe të Dinës e Selmanit t'Avdisë
kangë Dërveni, pa qiteli
me plot trimni e ashikni
atë lezet (edhe një herë) me përjetue
oxhakin e vjetër ta shoh tuj timue
me fëmijë lazdranë tuj lodrue
....
O moj Gjermani, sa borxh të kam
nuk po qahem, por vendi s'më mban
ku kam le du me u kthye edhe një here
ta kall zarrmin si për ditë vere
ta ngoj "sharkin" ujkun ta lehë
n'tufë t'dhenve mos me "pre"
Ku janë ato peta t'nanës, ajo fli
prapë në sofër koranik e tatli
n'Çeshëm t' Re ujë me pi
nëse koha s'më kthen n'rini
ka rrasë vorri për t'pushu,
këtë dhe Zoti e ka beku
se n'dhe të'huaj vdes shpresa
fshihet emri, t' mbulon harresa

I PLAKUR MUHAXHIR

Iku si fëmijë e kthehet i thinjur në mëhallën e vjetër
Iku në kohë ikjesh nga zullume të mëdha e të vogla
Një shtet hasëm dhe shumë hasëm
prapa avllive të matnin për çefin

Është pak të thuash "kohë e çuditshme"
Në sytë e fëmijës kishte shumë pikëpyetje
kur hipën në trenin për Anadoll

"Të ishte për mua s'do të ikja kurrë
Të diturit i ndiqte shteti, por Axhën e ndoqi hasmi,
babai i shkoi pas
t'ia prujë shpinën"

Menduan se rrësku do të ishte hallall
por vendi mysliman vetë lëngonte nga veset
me gjithë dëshpërimin
kthim prapa s'kish
s'dihej ç'kish pas çdo muri

Mes muresh të reja kërkon dritaret
Në mëhallën që s'e njihte
Pesëdhjetë vjet pas i kthyer
Ca mure avlie të vjetra
e më shumë mure të reja,
një shtëpi e vjetër mëhalle e paprishur
si eshtra kujtimesh

Në mëhallë trazon kohën e zverdhur
Përmend shumë emra farefisësh,
më shumë të vdekur se të gjallë
Gjysmë shekulli s'është pak syrgjyn
Ranë sisteme,
u shthurrën e u ndëtuan shtete
Veç koha e kujtimeve aty ka mbet'

Shumë shtëpi të reja ndërtuan në Stamboll
Familja e madhe, me mbiemër të ri
Akbashli me kuptimin Kokëbardhë
As turkë të pastër, as shqiptarë të shlyer
Me rrënjët n'vend t'lindjes
E degët që i fryn erë deti përtej

"Unë nuk e harroj shqipen asnjëherë!"
Flet Baftiu i kthyer në mëhallën e vjetër
"I kujtoj pleqtë, farefisë, arat e kodrat
Ato veç me mua do të vdesin"

Shumë foto për kujtim te vendi i shtëpisë
Tash shtëpia tjetër kujtimit i ve perde kohe
S'është kulmi, as muret, as streha
as themelet
mbetet një foto te pusi i mbetur
Një evokim kujtimesh me kushëririn e plakur
te hija e manit qindvjeç
Për kohët e burgjeve e hasmërive,
Për kohët e dasmave me sehire te gjibrja
Kur për një mindil vrapohej e kërcehej trihapësh
E hidhej guri tëhu

Vetëm të bieje në sy,
Që emri larg të të përmendej

“Gjysmë shekulli i vonuar, e di,
Por bija të fle e çohesha me mendjen këtu
Jam si lumi që rrjedh por ka veç një burim
Trupi më shëtit botës,
por mendja është si lisi
Nuk shkulet prej ku ka mbirë

Mund të shkoj dhe vij kur t’më teket
Njësoj e kam ku i gdhij mëngjeset
atje muhaxhir i përjetshëm,
këtu i huaj ndër breza t’rinj
një grusht dheu e marr me vete
në rrasht lulesh do ta ruaj,
ta ndjej përjetë erën e tokës sime
por dhe kur të vijë dita
grushti i parë mbi varr
nga dheu i vendlindjes të jetë
që sytë çelë t’mos më ngelin
me shikim të ngrirë përtejdeti”

(2017)

SHËNIME PËR AUTORIN

Daut Nexhbi Dauti, u lind më 31 mars 1961 në fsh. Bojanë-Shkup, Republika e Maqedonisë. Shkollimin fillor e ka kryer në vendlindje, Ohër dhe Shkup. Në Shkup ka kryer gjimnazin Zef Lush Marku dhe Fakultetin e Gazetarisë në Univerzitetin "Qirili e Metodi". Jeton në Shkup që nga viti 1972.

Përveç kësaj përmbledhje(**"Syri i keq",** 2017), Daut Dauti ka botuar edhe këto vepra letrare dhe publicistike: **"Ëndërr e përdalë",** poezi, ("Flaka e vëllazërimit", 1989), **"Shartimi i ëndrrës",** poezi, ("Flaka e vëllazërimit", 1991), **"A vdes ëndrra",** poezi, ("Shkupi", 1997), **"Baseni i troftave në Malin e Thatë"**, tregime("Shkupi", 2001), **„Sytë e mësyshit",** tregime("Shkupi", 2014), **"Shqiptarët e Ukrainës"(**udhëpërshkrime), me bashkautor Sefer Musliun("Shkupi", 1996), "50 vjet Ansambli "Emin Duraku"(monografi), 1997, **"Të shkruarit për median e shtypur"** (manual profesional për gazetarët(grup autorësh).

Ka punuar në gazetën "Flaka e vëllazërimit"(nga viti 1998 ndërroi emrin në "Flaka") në periudhën 1988-2004 si gazetar, redaktor rubrikash, si dhe kryeredaktor dhe redakor përgjegjës. Në vitin 2002 merr mirënjohjen më të lartë gazetareske në Maqedoni "Mito Haxhivasilev-Jasmin" për kolumnat e botuara në gazetën më të madhe të pavarur aso kohe, "Dnevnik" që trajtonin periudhën pas konfliktit të vitit 2001 në Maqedoni. Në vitin 2013, mori çmimin "13 Nëntori" që Qyteti i Shkupit ia ndau për publicistikë dhe gazetari.

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Cikli: KUR FATI S'I DO HERONJTË	7
Heronjtë e këngës	8
1. (heroi i pavdekshëm i këngës)	9
2.(heroina tragjike e paemër)	12
3.(allxhoja i pafajshëm)	15
4.(nëna e pikëlluar)	17
5.(krushqit që u bënë varrtarë)	19
6.(heroi i padukshëm: vrasësi)	20
Kthimi i Doruntinës	22
Farë djalli	24
Vetmashtrim	27
Boshësi	29
Vrasës shpirti	30
Takimi me fatin	32
Fati s'i do heronjtë e vet	33
Cikli: STINA SHTALB E VARGUT	35
Si të heshtë kënga	36
Gjakim në qytetin gri	37
Poemth për ty	38
Tufë sekrete vargjesh	41
Hijet	43
Si më nevrikos	45
Kur të vijë qershori	47
Një ëndërr në fyt	48
Ka mundur ndryshe	50
Dy botë	51
Shi bie	53
Binte shi atëherë	55

Kujtoj 57
Nën dritën e neonit 58
Rishtaz... 59
Larg 60
Kthimi në qytet 62
Zbardhja e një dite 63
Dergje vargjesh 64
Një nate tetori ika... 65
Një takim gjenerate 67
Mëngjes i qetë 68
Stinët e motmotit 69
Në mesnatë 70
Mërzi e përjetshme... 71
Pagjumësia jote 74
Para pasqyrës 76
Është koha 77
Peizazh 78
Përvjetor... 79
Një pritje meritoj? 81
Sogjetar 83
Bisedë telefonike e pabërë 84
Lot dhe shi 85
Kaptinë e mbyllur 87
Dritarja 88
Pritje kot 89
Idil vere 90
Ruaje zot 92
Hijet në terr 94
Dasma në katund 95
Poeti dhe të harruarit 96
Hije nate 97

Ty-ty- ty... 98
Jetë e re 100
Po të mos ishe ti 101
Cikli: PLAGË TË MOÇME, PLAGË TË REJA 103
Fati i sherbëtorëve të perandorisë 104
Kthimi i Hasan Prishtinës në shkup 108
Rrëfimet e heshtura të Ximës 110
Kur babain e lodhi jeta 113
Një jetë në mërgim 116
Shtegtarë të botës 119
Mosha e jetës 122
Çajtore në mes të evropës 123
Përsëri po qeshemi ne 124
Kënga për Rexhep dhe Felek Logrin 125
Një varr për trimin 129
I plakur në gurbet 134
I plakur muhaxhir 136
Shënime për autorin 139
Përmbajtja 140